



Republika e Kosovës / Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Kuvendi Komunal Rahovec/Skupština Opštine Orahovac/Municipal Assembly Rahovec



PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës së Rahovecit, mbajtur më 15 mars 2011, me fillim në ora 10, në sallën e KK-së. Të pranishëm: këshilltarët e KK-së, kryetari i Komunës z.Smajl Latifi, nënkryetari i Komunës z.Hazër Tara, përfaqësuesi i KFOR-it, KDI, CDI, drejtorët e drejtorive, mediat dhe një numër i qytetarëve.

Mbledhjen e ka kryesuar z.Kujtim Popaj, kryesues i Kuvendit i cili në fillim ka përshëndetur të pranishmit. Ai ka ftuar këshilltaren e re Vjosa Morina e cila bënë zëvendësimin e Florije Boshnjaku të jep betimin meqë është marr konfirmimi nga KQZ. Vjosa Morina ka dhënë betimin e këshilltares të KK-së.

Kryesuesi – për mbledhjen e sotme propozoj këtë

REND DITE

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar,
2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2009,
3. Shqyrtimi i çështjes së pezullimit të nxënësve nga procesi mësimor të Shkollës së mesme “Xhelal Hajda-Toni” në Rahovec dhe “12 Maji” në Ratkoc,
4. Shqyrtimi i projekt vendimeve për caktimin e zonave të interesit të veçantë,
5. Shqyrtimi i kërkesës së KRM “Eko-Regjioni” SH.A. Njësia Operative Rahovec,
6. Shqyrtimi i Raportit të punës së Avokaturës Publike Komunale në Rahovec për vitin 2010,
7. Emërimi i anëtarëve të Komisionit të aksionarëve për aksionet e KRM “Eko-Regjioni”,
8. Shqyrtimi i projekt vendimit për orarin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit për vitin 2011,
9. Plani i punës dhe informata e Kryetarit të Komunës së Rahovecit dhe
10. Të ndryshme.

Nahit Elshani – është e rrugës që kryetari i Komunës ta prezantoj Qeverinë e re komunale si dhe të deklaroj se a ka koalicion për këtë qeverisje komunale, sepse asnjëherë nuk kemi qenë zyrtarisht të informuar për përbërjen e ish Qeverisë komunale, që është një praktikë jo e mirë.

Labinot Berisha – kërkoj përgjigje, meqë është marr vendim që në seancën e radhës të jetë në rendin e ditës degradimi i shtratit të Drinit të Bardhë dhe tokave bujqësore përreth, pse nuk është vendos kjo dhe a mund të presim në seancën e radhës që të vendoset si pikë. Po ashtu kërkoj që të jetë pikë e rendit të ditës shqyrtimi i kontratave tremujore për të gjithë nëpunësit civil në administratën e Komunës, pasi që në bazë të Ligjit Nr. 03/L-149 për shërbyesit civil të Republikës së Kosovës të miratuar më 13.05.2010, bijën në kundërshtim të plotë me të kontratat tremujore.

Salih Hoti, rendi i ditës është i stërngarkuar me 10 pika, që janë shumë të rëndësishme e nuk janë debatuar as nga Qeveria e kaluar, kështu që rendi i ditës të jetë më i shkurtër, ndërsa seancat të thirren më shpesh.

Esad Haxhijaha, – kam një pyetje dhe një kërkesë. Pyetja ka të bëjë me informatën rreth regjistrimit të qytetarëve të Kosovës, çka është bërë në Komunën tonë, ndërsa kërkesa është në emër të më shumë se 10 pensionistëve në Rahovec që të vihet në rend dite – çështja e kompensimit të tri pagave të fundit. Kjo është dashtë të zgjidhet me Ligjin mbi pensionistët, e meqë ky Ligj nuk është aprovuar atëherë sipas rregullave punohet sipas dispozitave e ligjeve të cilat janë në fuqi. Në disa komuna, disa pensionistë kanë fituar të drejtën nëpërmjet gjykatës, të

shihet mundësia që atyre pensionistëve të cilët kanë qenë në marrëdhënie pune deri në ditën e pensionimit dhe t'i kompensohet ky obligim i pagave në nivel të pagës së mëparshme.

Avdullah Kryeziu, –në KPF nuk janë shqyrtuar të gjitha pikat dhe pajtohem me z. S.Hoti se rendi i ditës është i ngarkuar. Prandaj prej pikës 5 deri te pika 8 të cilat nuk janë shqyrtuar në KPF nuk është dashtë të jenë në rend të ditës. Në pikën 10-të ndryshme, duhet të jetë – pyetje dhe përgjigje të këshilltarëve.

Xhemali Haxhimustafa, –ndaj mendimin e shumicës se 4 pika nuk janë shqyrtuar në KPF, nuk janë të përgatitura dhe nuk e kanë vendin që sot të shqyrtohen, por nëse aprovohet rendi i ditës nga të pranishmit, atëherë do të marr pjesë në diskutim. Në aspektin procedural disa nuk janë prezantuar ashtu si duhet, disa nuk e kanë vendin sepse Kuvendi nuk merret me çështje individuale sepse është organ kolektiv dhe disa të tjera nuk janë përgatitur në aspektin profesional sa duhet.

Kryesuesi, – në lidhje me propozimin e Labinotit për shtratin e lumit Drini i Bardhë, presim të kontaktojmë me Zyrën ligjore në kuadër të MAPL dhe në bazë të udhëzimeve të shohim se çfarë vendime mund të marrim lidhur me këtë çështje dhe në seancën e radhës me siguri do ta kemi si pikë të veçantë të rendit të ditës. Sa i përket vërejtjes së S.Hoti, vetëm pika 5 dhe 6 nuk kanë kaluar në KPF, ndërsa pika e 7 – kërkesa e Njesisë së “Eko regjionit” ka arritur pas mbajtjes së mbledhjes së KPF.

Nahit Elshani –kërkova që kryetari i Komunës të prezantoj Qeverinë komunale para këshilltarëve e pastaj të shkohet në shqyrtimin e rendit të ditës dhe rendi i ditës nuk ka kaluar në KPF me përjashtim të 4 pikave të para, mirëpo meqenëse është fillimi i punës së kryetarit mund të bëjmë përjashtim që Plani i punës dhe Informata e kryetarit të jepet sot, ndërsa pikat tjera nuk duhet të gjejnë vend këtu pa kaluar në KPF.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – po ju prezantoj përbërjen e Qeverisë së re të Komunës së Rahovecit: Hazër Tara, nënkryetar i Komunës. Florije Boshnjaku drejtoreshë e Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, Lenhard Hamza drejtor i Drejtorisë për Administratë të Përgjithshme, Shemsi Ibrahim i drejtor i Drejtorisë për punët inspektuese, Afrim Limani, drejtor i Drejtorisë për financa dhe buxhet, Besa Hoxha-Beqiri-DKA e cila për shkak të gjendjes së keqe shëndetësore nuk është këtu, Përparim Krasniqi, drejtor i Drejtorisë për shërbime publike komunale dhe emergjencë, Fatmir Iska drejtor i Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë, Arben Zeka drejtor për KSR, Ramadan Gashi drejtor i Drejtorisë për urbanizëm, ambient dhe planifikim hapësinor, Artan Zenuni drejtor i Drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural dhe Musa Cena drejtor i Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim, i cili aktualisht gjendet në Itali për një projekt që kemi bashkë me USAID-in. Biografite e drejtorëve të Qeverisë komunale mund t'i shihni në WEB faqen zyrtare të Komunës. Ne jemi këtu për të dëshmuar dhe demonstruar gatishmërinë për një qeverisje të mirë, të përgjegjshme, të drejtë, transparente dhe llogaridhënëse para qytetarëve të Komunës dhe para jush. Unë kam deklaruar publikisht se kam koalicion me qytetarë të Komunës së Rahovecit dhe jam i hapur për bashkëpunim të mirëfilltë me të gjitha institucionet relevante të Komunës së Rahovecit, nga Kuvendi Komunal, me të gjithë qytetarët e Komunës, Qeverinë nuk e kam bërë me parti, por është një Qeveri e cila ka filluar veç me hap kapitullin e qeverisjes së mirë, e cila i duhet qytetarëve të Komunës së Rahovecit.

Nahit Elshani,– shumicën prej tyre ne nuk e njohim, nga një CV të shkurtër për secilin a mund ta jepni zotëri kryetar. Çka janë me profesion, a kanë një përvojë apo janë studentë të cilët nuk dihet a i kanë përfunduar studimet dhe janë bërë drejtorë dhe përvojën e parë do të kenë si drejtorë të drejtorive në Komunën tonë.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës–e kuptoj z. Elshani, ju thash se në WEB faqen zyrtare të Komunës mund t'i shihni biografitë e tyre. Hazër Tara, nënkryetar, është ish i burgosur politik, veprimtar i kahershëm, inxhinier i makinerisë Fakultetin e kryer në Zagreb. Shemsi Ibrahim është profesor i kimisë, ka të kryer FSHMN, ka qenë drejtor i SH.F në Celinë. Florije Boshnjaku, është juriste dhe ka mjaft përvojë pune. Lenhard Hamza, ka dy fakultete: Fakultetin e shkencave politike dhe Jurist, djali i dëshmorit Gëzim Hamza, është djali i ri, energjik, me vullnet të madh

dhe është duke punuar në përputhje me kërkesa imediate e që janë aspiratat e qytetarëve të Komunës, është drejtor i Drejtorisë për administratë të përgjithshme. Afrim Limani, është ekonomist, ka punuar në QPS, është veprimtar i hershëm, tani është drejtor i Drejtorisë për financa dhe buxhet. Besa Hoxha-Beqiri, është magjistër e gjuhës dhe letërsisë, është drejtoreshë e Drejtorisë për arsim, ka punuar si zyrtare e arsimit në DKA dhe në disa institucione. Fatmir Iska, është jurist, është drejtor i Drejtorisë për gjeodezi, kadastër dhe pronë, ka punuar në disa institucione private. Përparim Krasniqi, është master në shkencat sociale, është drejtor i Drejtorisë për shërbime publike komunale dhe emergjencë. Arben Zeka, jurist, nuk ka përvojë në institucione por është duke fituar përvojë dhe po dëshmohet se është i gatshëm t'i kryej ato detyra dhe angazhimet që i takojnë një drejtori në fushë veprimtarinë e kulturës, sportit dhe rinisë. Ramadan Gashi, është inxhinier i ndërtimtarisë, është drejtor i Drejtorisë për urbanizëm, ambient dhe planifikim hapësinor, ka një përvojë menaxhuese. Artan Zenuni, është drejtor i Drejtorisë për bujqësi, pylltari dhe zhvillim rural, ka punuar në një Kompani si drejtor financiar, tani është në punë e përpjekje për t'i ushtruar të gjitha përgjegjësitë, detyrat dhe në kuadër të angazhimeve dhe përkushtimeve që ka për të punuar në fushë veprimtarinë e bujqësisë, pylltarisë dhe zhvillimit rural. Musa Cena, ka Fakultetin ekonomik, është ekonomist i njohur dhe është drejtor i Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim. Për secilin drejtor të drejtorisë ju mund të gjeni CV në WEB faqen zyrtare të Komunës. Kjo është Qeveri e re, me frymë të re, me përkushtime të reja, me vullnet dhe energji pozitive dhe në momentin kur konstatoni që nuk është duke punuar mirë, ka vërejtje, ka shkelje, ka parregullsi, atëherë kryetari i Komunës do të ndërmerr masa dhe veprime për ta korrigjuar qeverisjen e vetë. Më 1 shkurt e kanë pranuar detyrën dhe deri tani janë duke punuar për të mirën e qytetarëve të Komunës në dy drejtime kryesore: e para, për të sanuar gjendjen sepse siç e dini, Komuna e jonë ka kaluar nëpër një situatë të jashtëzakonshme dhe e dyta, për të ndërmarr hapat e duhura që të jemi në koherencë me zhvillimet dhe të jemi konsistent në realizimin e objektivave që i kemi si Qeveri komunale ndaj qytetarëve të Komunës dhe sipas Ligjit.

Xhemali Haxhimustafa, – parafolësit thanë se 3 pika nuk janë shqyrtuar në KPF ndërsa unë jap arsyetime të qëndrueshme për 2 pika tjera të cilat nuk e meritojnë që të trajtohen në Kuvend. A do të votojmë rendin e ditës si është apo do t'i heqim disa pika e pastaj të votojmë kuvendarë le të japin mendimin e vet.

Salih Hoti, –meqenëse ka qenë urgjencë për t'i shqyrtuar çështjet propozoj që kësaj radhe të kaloj rendi ditës ashtu siç është i propozuar ndërsa herave tjera të jetë si rregull që asgjë pa kaluar në KPF të mos dërgohet në Kuvend pos diçka që është e jashtëzakonshme, por të jetë arsyetimi i plotë dhe përmbajtësor që edhe neve të na bind që përfshihet në rend të ditës të Asamblesë komunale.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës –ndoshta për herë të parë në Kuvend dërgohet një Plan vjetor i punës, me kryesuesin e Kuvendit kemi parë se nuk është domosdoja që të kalojë edhe në KPF, pasi që ne pas 6 muaj do t'ju informojmë se a jemi në përputhje me këtë plan të punës apo jo, nuk është temë për debat, por është në funksion të transparencës për t'i informuar këshilltarët me Planin vjetor të punës së Qeverisë komunale.

Nahit Elshani,– pajtohem që Plani i punës, informata e kryetarit dhe orari i mbledhjeve të KK-së mund të kalojnë sot, mirëpo pikat 5, 6 dhe 7 duhet të hiqen prej rendit të ditës, meqenëse janë të një rëndësie të veçantë dhe nuk kanë kaluar në KPF.

Xhemali Haxhimustafa,– në qoftë se i referohemi Udhëzimit administrativ të cilin e keni dërguar me material dhe nëse e analizojmë mirë nenin përkatës pika nr. 3 – shqyrtimi i çështjes së pezullimit të nxënësve nga procesi mësimor, nuk e ka vendin këtu sepse në mënyrë taksative thuhet se Kuvendi nuk merret me këtë çështje por informohet si dhe për pikën 7 para emërimit të anëtarëve duhet të shkarkohen anëtarët të cilët kanë qenë të emëruar më parë.

Fehim Fetoshi,– pasi që pika e tretë e rendit të ditës është shqyrtuar në KPF është mirë që edhe në Asamble të debatohet këtë çështje, por që rendi i ditës të aprovohet pa pikat 5,6 dhe 7.

-Kryesi ka hedhë në votim rendin e ditës për mbledhjen e sotme pa pikën 5, 6 dhe 7 dhe pas votimit ka konstatuar se me **3 vota “kundër”** dhe **2 “abstenime”** aprovohet rendi i ditës.

1. Procesverbali nga mbledhja e kaluar aprovohet pa vërejtje.

2. Shqyrtimi i Raportit të Auditorit të Brendshëm për vitin 2009.

Xhihad Vuçitërna – ky raport është shqyrtuar në KPF dhe është për vitin 2009 ndërsa në material po figuron për vitin 2010, mirëpo tani është bërë një përmirësim. Do të thotë që ky raport është i Qeverisë së kaluar kur unë nuk kam qenë anëtar i Asamblesë komunale e as drejtorët të cilët janë në këtë Qeveri, por kanë qenë ish drejtorë tjerë të cilët nuk janë prezent këtu. Pyes kryesuesin edhe të gjithë juve cili është qëllimi i shqyrtimit të këtij Raporti, në qoftë se ne nuk mund të kërkojmë përgjegjësi prej dikujt, në lidhje me shkeljet e bëra që janë paraqitur në raport që është shumë voluminoz sepse çdo tender ka shkelje. A duhet të kërkoj përgjegjësi prej kryetarit të tanishëm, drejtorëve të tanishëm, a do të japin këta shpjegime për këto shkelje, çfarë konkluzion të marrim në lidhje me këtë raport apo vetëm duhet t'i shqyrtojmë dhe diskutojmë këto shkelje që janë bërë.

Nahit Elshani, – këtu nuk është qëllimi të kërkojmë përgjegjësinë por më tepër është një informatë ku janë evidentuar të gjitha shkeljet dhe lëshimet që janë bërë nga ish Qeveria komunale. Ne si opozitë atë kohë i kemi potencuar këto shkelje mirëpo zëri ynë nuk është marr parasysh fare. Këto projekte që po realizohen janë projekte të fushatës. Kjo është vërtetuar me të gjeturat që janë hasur në këtë raport. Pajtohem që ky raport ka qenë dashtë që të shqyrtohet në fillim të vitit 2010. Ky raport nuk i ka pasqyruar të gjitha drejtoritë e Kuvendit komunal por vetëm disa. Ajo që është si lëshim është se këtij raporti i mungojnë komentet nga ana e ish menaxhmentit të Komunës respektivisht nga ana e drejtorëve dhe ish kryetarit të Komunës, që do të thotë se këto të gjeturat në këtë raport kanë të bëjnë me shkelje të rënda të Ligjit, sidomos Ligjit mbi prokurimin publik e që paraqesin vetëm komentet e auditorit të brendshëm, por jo edhe komentet e menaxhmentit. Andaj është pyetje për auditorin e brendshëm se a i është ofruar ky raport ish kryetarit të Komunës dhe ish drejtorëve për shqyrtim. Për këtë kërkojmë përgjigje. Vërejtje tjetër që kam për auditorin e brendshëm është se ai asnjëherë nuk ka paraqitur para Komitetit për politikë dhe financa Planin vjetor të punës për auditim të brendshëm për çka obligohet me LVL neni 52.2. Po ashtu adutimi nga ana e auditorit të brendshëm duhet të jetë permanent gjatë vitit dhe jo një vit prapa. Të gjetura dhe shkeljet më të rënda të Ligjit mbi prokurimin publik janë hasur në Zyrën e prokurimit, ku drejtorët janë urdhëruar për shpallje të tenderit, autorizues për disponueshmërinë e mjeteve, kryetar të Komisionit për vlerësim të ofertave, formues të Komisionit për pranim teknik, çka lenë të nënkuptohet që drejtori ka qenë mbi kryetarin dhe lenë mundësinë të keqpërdorimeve të shumta të buxhetit komunal. Kur një drejtor i ka të gjitha këto kompetenca edhe pse janë në kundërshtim me Ligjin atëherë me siguri që këtu ka pasur keqpërdorime. Kriter për vlerësimin e ofertave është aplikuar operatori më i favorshëm ekonomikisht e jo çmimi më i ulët ku Komuna respektivisht buxheti komunal është dëmtuar me mjete financiare dhe unë i përmendi vetëm raste që i ka paraqitur auditori si ai për 8.100 €, rasti tjetër për 940 € dhe rasti i fundit ku për 1.000 € pagesa është bërë më shumë se sa që ka qenë kontrata e nënshkruar zyrtarisht. Ka shumë aktivitete të prokurimit ku janë ku janë aplikuar metoda e ofertimit të hapur respektivisht me 3 oferta. Në asnjë tender nuk janë aplikuar penalet për mosrespektim të Planit dinamik të kryerjes së punëve edhe pse janë hasur vonesa disa mujore. Në shumicën e tenderëve mungojnë raportet e pranimit teknik të punëve. Koha nga hapja e ofertave deri te vlerësimi është edhe deri më 9 ditë, çka lë dyshime për marrëveshje dhe keqpërdorime me operatorët ekonomik. Betimi i anëtarëve të komisionit për vlerësimin e ofertave është bërë me vonesë dhe atë me nga 4 – 20 ditë. Nuk ka asnjë dosje e tenderit që nuk ka shkelje të LPP, tani po vërtetohet ajo që ne sa herë e kemi ngritë zërin që me rastin e caktimit të drejtorëve për kryetar të komisioneve po bëhet shkelje e LPP nga ana e kryetarit të Komunës ndërsa kryetari thoshte se Ligji nuk më ndalon as mua të jem anëtar i komisionit. Në Drejtorinë për financa ku thuhet se realizimi i të hyrave nga qiraja është bërë konform planit ndërsa më poshtë thuhet se inkasimi ka qenë në shkallë të ulët të qirasë. Në fakt janë pranuar ato mallra që po ashtu lë të dyshohet se janë bërë pagesa fiktive pa pranim të mallit.

Blerja e mallrave pa hyrë në procedurat e prokurimit, shpenzimet e tejkaluara për dreka zyrtare pa mbulesë. Zyra e aseteve nuk mban regjistrim të plotë të pasurisë dhe nuk dihen se cilat janë asetet e Komunës. Të gjitha drejtoritë të cilat janë auditue kanë bërë shkelje të rënda të Ligjit dhe propozoj që kryetari i Komunës me kryesuesin e KK-së këtë raport t’ia paraqesin Prokurorit publik si dhe Agjensionit anti korrupsion në mënyrë që shkelësit e Ligjit të ballafaqohen me drejtësinë.

-Fehmi Hoxha,— që në start të votimit të këtij rendit të ditës isha kundër për shumë arsye, mirëpo tani për pikën që debatojmë – Raportin e auditorit të brendshëm për vitin 2009. Pas auditimit të auditorit të brendshëm është ftuar Auditori i përgjithshëm për Komunën e Rahovecit të cilin ne e kemi shqyrtuar më 27.07.2010. Ne nuk jemi as gjykatë e as prokurori që të merremi me auditimin e brendshëm. Pajtohem me atë që u tha se auditori i brendshëm nuk e ka marr seriozit auditimin e të gjitha drejtorive, por në mënyrë të pjesërishme që do të thotë se ka pasur anime dhe konsideroj se ne fare nuk duhet të merremi me këtë pasi që auditori i përgjithshëm i pavarur e ka prezantuar Raportin i cili ka kaluar në Asamblenë komunale.

Avdullah Kryeziu,— gjatë leximit të këtij raporti nuk kam mundur të besoj se mund të bëhet aq shkelje të rënda të LPP dhe të Ligjit mbi financat publike në një Komunë të Kosovës. Shkeljet i kemi te drejtoritë, sepse anëtarë të komisioneve janë drejtorët e që kjo është konflikt interesi dhe nëse ata i vlerësojnë tenderët është shkelje e ligjit dhe konflikt interesi. Te “Matrexi” Qendër agrare në Xërxe dosja e tenderit nr.10 është shkelje ku drejtori është vlerësues dhe në fund drejtori vendos kujt t’i jep tenderin që është shkelje eklatante e prokurimit publik dhe Ligjit mbi financat publike. Kemi tenderin nr. 88 dhe 105 ku shpalljen e bënë drejtori i drejtorisë, njëherësh është edhe autorizues si dhe kryetar i Komisionit. z.Kryetar, me qëllim që ju të merrni masa në këtë drejtim që të mos ndodhin këto gjëra sepse, sipas dosjes së tenderit nr. 79 ju ende jeni borxh për shtrirjen e internetit në KK të Rahovecit sepse operatorit ekonomik nuk ju kanë paguar mjetet, që është shkelje e ligjit. Konkluzione të cilat i ka dhënë auditori përkojnë me atë çka ka audituar e po ashtu edhe rekomandimet, mungojnë komentet e punëdhënësit gjë që edhe kjo është një shkelje sepse për çdo konkluzion dhe rekomandim të auditorit, punëdhënësi duhet të jep komentet e veta se a pajtohet apo jo me të gjeturat e auditorit të brendshëm.

Salih Hoti,— është problem që në këtë raport të gjen diçka që është pozitive dhe që është e përputhshme me procedurat dhe Ligjin në fuqi. Vetë faqja e parë e Raportit të auditimit bie në kundërshtim me atë për çka ka raportuar. Këtu thuhet raporti për vitin 2009 ndërsa një resht më poshtë thuhet për periudhën audituese 01.01.2010 – 31.12.2010 si dhe në brendi të raportit përmendet edhe periudha 2010 që do të thotë se janë ngatërruar periudhat. Prokurimi dhe ata që kanë urdhëruar hapjen e procedurave nuk e kanë përfill asnjë procedurë. Janë fshehur edhe kopjet e procesverbaleve për kryerjen e punëve. Për pranimin e materialeve nuk figurojnë nënshkrimet e komisioneve që kanë pranuar një punë apo material. Më vjen keq që këtu nuk kemi komentet e ish menaxhmentit lidhur me këto që ka konstatuar auditori i brendshëm me qëllim që ne të kemi mundësi me konstatuar që mos kemi të bëjmë me vlerësime të njëanshme të auditimit të brendshëm apo thjeshtë këto të thëna janë të vërteta apo jo. Besoj që shumë fakte që ka nxjerr auditimi i brendshëm janë të vërteta. Ne nuk kemi dokumente burimore para veti për të ditur saktë se çka ka ndodhur. Prandaj është sugjerimi im që Qeveria komunale bashkë me kryetarin e Komunës këtë Raport të auditimit të brendshëm ta operacionalizoj në drejtoritë përkatëse dhe secili nga drejtorët përkatës të merret me ekzekutimin e vendimeve të auditorit të brendshëm. Është rekomandim i auditorit të brendshëm ku thuhet që drejtori i departamentit mos të jetë urdhërues, vlerësues dhe auditues, e që në të kaluarën këto kanë qenë. Më vjen keq që ata nuk janë këtu për të folur sy më sy. Këtu auditori i brendshëm thotë se disa çështje ose disa procedura të cilat janë të rëndësishme jo materiale nuk janë përfillur dhe për këto duhet të na tregojë auditori i brendshëm. Aspekti tjetër është që nëse Qeveria komunale që është e thirrur të lëshohet pak më në detale dhe me dhënë konstatime më të plota, kisha kërkuar që gjërat të hetohen shumë mirë, drejtë dhe në mënyrë të paanshme, dhe nëse ka shkelje të rënda të merret një konkluzion ose vendim që çështja të procedohet në Prokurorinë adekuate. Ajo çka i mbetet kësaj Qeverie është që

t'i respektoj këto rekomandime 100% sepse është hera e parë që kemi në Kuvend raportin e auditimit të brendshëm sepse një raport i tillë asnjëherë nuk është shqyrtuar në Asamble.

-Xhemali Haxhimustafa,— për të qenë një auditor i brendshëm i mirëfilltë duhet në përpikëri të respektoj Ligjin mbi auditimin dhe ky Ligj thotë nuk është i pavarur deri sa ai duhet patjetër të ketë Komisionin e auditimit të cilit ai i referohet çdo tre muaj, duhet të ketë planin e auditimit vjetor dhe kurrresi në gjysmën e marsit 2011 në të shqyrtojmë auditimin e vitit 2009. Kishim me qenë në trendin e kohës në qoftë se ky auditim kishte ardhur, mos jo për krejt vitin, bile për 6 muaj, nëpërmjet Komisionit të auditimit, nëpërmjet rekomandimeve dhe përgjigjeve që u jepen diku kah marsi i vitit 2010 dhe do të ishte shumë më funksionale.

Nahit Elshani,— në mbledhjen e KPF auditori i brendshëm ka deklaruar se ka qenë i kërcënuar më herët të bëjë publik këtë raport nga ish menaxhmenti që është edhe më shqetësuese.

-Burim Krasniqi,— kam tri çështje: e para fillimi i procedurës së prokurimit është diçka që fillon dhe ato janë diçka që janë kryer, mirëpo ajo e dyta janë projektet që janë në ekzekutim e sipër e që duhet të kihet parasysh që pranimet teknike me të vërtetë të bëhen si duhet dhe të ekzistojnë raportet në dosjet e ardhshme, e treta është bartja e nxënësve Zatriq-Rahovec dhe Malësia e Vogël-Gexhe, më duket si anomali sepse dokumenti i lejes së punës nuk është dhe vërtetimi mi kryerjen e obligimeve komunale nuk është.

-Feim Fetoshi,— Në momentin kur e kemi lexuar Raportin kemi parë e që faktikisht ky raport është për vitin 2010 e jo për vitin 2009 dhe jemi zhgënjyer menjëherë. Edhe pse nuk jam ekspert i kësaj çështje në dukje duket një raport i mirë, konciz, por edhe disa pyetje që kemi bërë në KPF nuk kam parë përgjigje siç kam pyetur për dosjen nr. 54 – asfaltimi i rrugës në fshatin Fortesë-Celinë. Në nga Fortesa dhe kolegë nga Celina e dinë që kjo rrugë nuk është e asfaltuar, ndërsa për këtë ekziston dosja e tenderit që është kryer kjo punë. Zotëriu që e ka bërë raportin e tha publikisht që ka qenë i kërcënuar, e kam pyetur a e ka lajmëruar kërcënimin në polici? Nëse nuk e ka lajmëruar në polici na lë neve të kuptojmë që ky zotëri e lenë veten apo punën për t'u kërcënuar ose organet e policisë dhe të hetuesisë nuk kanë vepruar nga momenti kur ky zotëriu ka lajmëruar, dhe tani lind pyetja se sa është i besueshëm një zotëri i tillë që edhe më tutje të punojë. Auditimi bëhet siç thotë kryetari për të pasur transparencë që drejtorët adekuat të përgjigjen se çfarë pune bëjnë dhe si e bëjnë.. Konsideroj se është një raport absolutisht i panevojshëm aq më tepër se kishte një pagë bukur të madhe, gati si kryetari i Komunës. Unë apeloj te kryetari i Komunës që të merret seriozisht me seriozitetin, legjitimitetin dhe kredibilitetin e këtij zotëriu dhe po ashtu apeloj që të merr masa që raportet të vijnë në periudha sa më të shpejta dhe të jenë më të saktë.

Jeton Kryeziu,— më intereson kush është autor i auditimit me emër dhe mbiemër. Këtu ka disa shprehje dhe ndoshta i ka nxjerr nga interneti si p.sh. tek opinioni i auditimit. Te auditimi i brendshëm nuk jepet opinioni i auditimit përveç për pasqyrat financiare. Unë mendoj se ky raport është i cilësisë, nuk është opinion i auditimit, tek dosja e tenderit nr. 32 vlera e projektit në Xërxe në shumën mbi 22.000 € ka të bëjë me sigurimin e projektit dhe nuk ka ndonjë shkelje, por është vetëm një borxh dhe atë 10% për sigurimin e projektit.

Sinan Ejupi,— në KPF kemi shqyrtuar gjerë e gjatë këtë temë, këtu janë evidente shkelje të mëdha, edhe pse nuk dyshoj në këtë auditim dhe e përgëzoj për punën jashtëzakonisht të pastërt se është një punë voluminoze, mirëpo këtu shumica e kolegëve thanë dhe pajtohëm me atë se është treguar njëra anë e medaljes, mungojnë komente dhe pa to nuk di sa mund të japim vlerësime për këtë auditim si dhe sa përputhet auditimi i brendshëm me auditimin e jashtëm i cili ka kaluar në këtë Asamble. Pasojat janë shkeljet e rënda mirëpo pa komente, është njëra anë e medaljes, ndërsa shkaktari dihet, sepse kush ka qeveris është shkaktar i shkeljeve. Ligjet e mëhershme nuk kanë lejuar që të bëhet auditimi i vitit ekzistues, por tani Ligji po lejon auditimin e vitit ekzistues. Nëse vazhdohet me praktikën që ti marrim pas dy viteve, Asambleja e ardhshme të jep opinione për shkeljet eventuale të kësaj Qeverie, atëherë unë besoj që nuk ka efekt por nuk ka ndoshta as logjikë që vetëm të bëhet komenti i shkeljeve eventuale që do të vinin më vonë. Pyes çka duhet të ndërmerr Asambleja komunale respektivisht kryetari i Komunës të mos i japim

shanse që në të ardhmen të bëhen shkelje të tilla, a duhet ne të marrim ndonjë vendim apo vetë ligji e detyron auditorin e brendshëm që të jetë në përcjellje të vazhdueshme që të ketë vonesa dy- tre mujore e jo vjetore, që të përcillet puna e tyre tremujore në periudhat pas tremujore e të kemi një auditim për çdo drejtori përkatëse ku edhe vetë drejtorët do të japin komentet e veta rreth punës së tyre, sepse kjo tani ne vetëm e shohim se çka është bërë, s'mund të bëjmë asgjë tjetër.

Nahit Elshani – konsideroj se nuk është mirë nga z.Fetoshi që të kërcënohet auditori për punën që e ka bërë. Të gjithë e thamë se mungojnë të dhënat, komentet e menaxhmentit, por nuk bënë të kërcënohet në këtë mënyrë siç bëri Feimi ku e thirr kryetarin e Komunës që të merr masa ndaj auditorit të brendshëm. Auditori i brendshëm është i pavarur në punën e vet dhe përgjigjet për të gjitha ato që i ka shkruar këtu nëse nuk janë të vërteta dhe të sakta. Nëse vërtetohet se ka gjëra të cilat nuk përkojnë me dokumentet zyrtare të cilat i ka audituar atëherë mund të merren masa, por jo në këtë formë me u shpreh në baza të them partiake. Auditori pasqyron gjendjen dhe konstaton të gjeturat dhe nuk jep komente askund sepse i ndalohet me ligj.

Feim Fetoshi – çdo fjalë e imja nëse ka tingëlluar si kërcënim, unë publikisht kërkoj falje edhe zotëriut edhe juve, sepse të gjithë më njohin nuk jam njeri që kërcënoj. Kërkoj falje nëse jam keqkuptuar. Kërkoj nga kryetari i Komunës që të shikoj legjitimitetin dhe kredibilitetin, e kam thënë dhe prapë e them të këtij zotëriu i cili ka thënë publikisht që ka qenë i kërcënuar. Nëse nuk e ka lajmëruar një kërcënim të tillë ka gabuar, por nëse ka lajmëruar dhe organet e hetuesisë nuk kanë ndërmarr asgjë apo janë në proces të hetuesisë është çështje tjetër. Është e zbehtë besueshmëria ndaj këtij auditori i cili hapur tregon që është kërcënuar dhe nuk kemi asnjë koment tjetër se çka ka rrjedhë nga ai kërcënim.

Avdullah Kryeziu, – auditori i brendshëm sipas Ligjit mbi auditimin e brendshëm është person i pavarur. Janë disa parime të auditimit në ligj, është parimi i ligshmërisë, integriteti i paanësisë dhe fshehtësisë. Dikush kërkon me këmbëngulje që auditori të zbulojë fshehtësinë dhe të thotë haptas, nuk kemi të drejtë se është pjesë ligjore dhe ai duhet t'i përmbahet ligjit. Komuna nuk ka Komisionin e auditimit, propozoj që të formoj këtë komision e këtë e lejon Ligji mbi auditimin e brendshëm sipas nenit 5. Si anëtar i Komisionit të auditimit duhet të jetë zyrtari kryesor administrativ e që në këtë rast është kryetari i Komunës si dhe 2 anëtarë tjerë të Komisionit. Gabim ka qenë që nuk kemi pasur një komision të tillë, sepse po të ekzistonte, ndryshe do të ishte ky raport, të dhënat në të si dhe ndryshe do të ishin keqpërdorime

Salih Hoti, – Po prejudikohet që ky kabinet qeveritar do të merret me çështje të auditimit apo do të anashkalojnë atë dhe këto paragjykime duhet lënë anash dhe nëse këta nuk, merren, mund të thuhet se nuk janë marr me këtë problem, e jo të themi në hap të parë që nuk ka me ndodh diçka pas periudhës së caktuar, nuk duhet të jemi tendencioz.

Feim Fetoshi – e ftoj kolegun Salih që të dëgjoj mirë deklaratën se çka flasin kolegët. po e përsërisë se u deklarua më herët se zotëriu ka qenë i kërcënuar dhe nuk është ndërmarr asgjë nga ky kërcënim, nuk ka përgjegjësie apo brengë të drejtorëve nga auditori dhe unë kurrfarë paragjykimi nuk bëjë.

Rasim Fazliu, – të gjeturat tregojnë që ka pasur mjaftë shkelje e që këtë e kemi konstatuar edhe në KPF, dhe se me vonesë po e shqyrtojmë këtë raport, mirëpo tani e tutje raportet e tilla të mos shqyrtohen me kaq vonesë, pasi që auditori i brendshëm e ka vetëm atë detyrë, e kur të vijë auditimi i jashtëm punë të jenë më në rregull. Është dashtë të ekzistojnë edhe komentet të drejtorëve përkatës që kanë qenë atëherë, kështu që tani këtë nuk mund të marrim si të vërtetë e as të pavërtetë. Në të ardhmen raportet të shqyrtohen për çdo 3 apo 6 muaj.

-Labinot Berisha, – ka gjëra të cilat janë të pakëndshme në këtë raport por mbetet të shihet si do të procedohet më tutje. Çështja e kërcënimit të nëpunësit civil të Komunës, është vepër e rëndë penale. Kërkoj urgjentisht nga institucionet, nga vetë kryetari i Komunës por edhe nga Policia që të merret me rastin, sepse kërcënimi është vepër shumë e rëndë aq më tepër kur ka të bëjë me një pozitë kaq të ndjeshme siç e ka auditori.

Smajl Latifi,— debati është konstruktiv por për një pikë të rendit të ditës është mirë të flitet një herë me të drejtë replike sepse këto i parasheh edhe Rregullorja e punës së Kuvendit. Raporti i auditimit të brendshëm është diskutuar në KPF, natyrisht që është shumë i vonuar, kur e kam pranuar detyrën menjëherë e kam pranuar edhe raportin dhe është diçka që i ka munguar raportit që ka qenë një shkelje ose një mos përmbushje e Planit vjetor të vitit 2010, nuk është audituar një Drejtori, menjëherë kam urdhëruar auditimin e asaj Drejtorie dhe ju së shpejti do të keni raportin e auditimit për vitin 2010 të një Drejtorie që ka pasur të auditohet vitin e kaluar. Për sa i përket angazhimit të auditorëve, është plani vjetor i punës dhe ne do të përpiqemi që t'i respektojnë të gjitha procedurat ligjore dhe të kryejnë punën e vet në mënyrë profesionale. Në qeverisjen tonë askush nuk do të ndjehet i kërcënuar në qoftë se do të punojë sipas Ligjit dhe në përputhje me interesat e qytetarëve të Komunës. Kam kërkuar edhe auditorin e jashtëm që të bëjë një incizim të thellë të gjendjes në Komunën tonë dhe shpresoj që kjo do të plotësohet në fillim të muajit prill e pastaj do të shohim çfarë shkelje, çfarë parregullsie ose të gjetura janë në Komunën tonë. Pra, unë do të kërkoj në vazhdimësi sepse jam shumë i interesuar të shënoj prerjen, midis asaj ku e gjetëm komunën dhe ku do të qojmë Komunën nesër. Prandaj, ju kisha sugjeruar auditorit që të punoj sipas ligjit sepse në të kundërtën ekzistojnë masat ligjore që do të ndërmerren ndaj secilit shërbyes civil i cili e shkel ligjin. Sa i përket kërcënimeve jam shumë i bindur që ne edhe ashtu jemi të obliguar që të punojmë sipas ligjit dhe askush nuk ka arsye që të ndjehet i kërcënuar nëse e bënë punën e vet sipas Ligjit. Unë shpresoj që në mbledhjen e ardhshme do të keni raportin e auditimit për pjesën e mbetur të përfunduar për vitin 2010, dhe shpresoj që shumë shpejtë do të kemi edhe një raport të auditimit nga auditori i jashtëm i cili do të auditoj edhe auditorin e brendshëm, jo pse nuk i besoj auditorit të brendshëm, por për shkak se është më mirë që të auditohet. Të gjitha procedurat, të gjitha aktivitetet, të cilat i ka zhvilluar Komuna janë në vitin 2010.

Kryesuesi, – edhe unë konsideroj se ky raport është me plot parregullsi sepse vetë volumi i raportit me mbi 40 fletë që ka, të gjitha ato paraqesin parregullsi për periudhën e paraqitur, e të cilat kanë të bëjnë me keq menaxhimin e mjeteve publike.

Binak Kryeziu, auditor i brendshëm – unë së pari draft raportin e dorëzoj te kryetari dhe te Njësia qendrore harmonizuese në Ministrinë e financave dhe buxhetit. Draft raporti ka afat 10 ditë për të dhënë komente dhe pas këtij afati nuk pranohen komente. Komente janë dhënë vetëm për dy raporte: Drejtoria për financa dhe buxhet dhe Zyra e prokurimit. Ato komente i kemi analizuar së bashku dhe të gjitha janë përmirësuar dhe janë ato që janë cekur në raport. Ne e bëjmë auditimin për vitin paraprak sepse nuk kemi çka të auditojmë për vitin vijues. Ne e bëjmë planin strategjik dhe vjetor, ku parashohimse çka do të auditohet brenda vitit. Auditimi bëhet për vitin paraprak, por ka mundësi të bëhet ndonjë ad-hoc auditim, në qoftë se kryetari ose drejtori e diktojnë ndonjë parregullsi ose shkelje ligjore. Sa i përket kërcënimit, ka qenë kërcënim verbal e jo kërcënim fizik. Nuk kemi pasur fare bashkëpunim të drejtorëve me Njësinë e auditimit. Ne si auditor jemi të pavarur dhe i përgjigjemi Ligjit. Çdo auditim e kemi bërë në bazë të fakteve dhe dokumenteve. Për të gjitha të gjeturat kemi dokumentacion – kopjet faktet i cili mbahet 7 vjet, në raport është gjendja faktike dhe unë kërkoj bashkëpunim më të madh. Deri më tani as KPF e as Asambleja nuk më kanë kërkuar raport.

Nahit Elshani –Tha se i kemi përmirësuar bashkërisht por, nuk është detyra e auditorit të merret me përmirësim. Ti e ke konstatuar gjendjen, shkeljet ndërsa e menaxhmentit është me dhënë komente të cilat ti duhesh me i pasqyruar në raport ndërsa ne nuk po shohim asnjë koment të menaxhmentit në raport. Raporti për me qenë kredibil, i saktë dhe i besueshëm duhet të ketë edhe komente nga menaxhmenti të cilat konstatohen në raport.

Fehmi Hoxha – po shoh një seriozitet shumë të madh nga vetë auditori i cili deklarohet që për dy drejtori kanë marr komente, që do të thotë me këta dy i kemi harmonizuar ndërsa me të tjerë nuk ka pasur komente dhe draft raporti u bë si raport. Kjo mund të bëhet si draft raport vetëm si raport përfundimtar për dy drejtori sipas juve dhe absolutisht komplet nuk është që është shumë joserioze.

Kryesuesi.– nëse dikush ka diçka të paqartë atëherë mund të drejtoheni me shkrim dhe në mbledhjen tjetër mund të prezantohen të gjitha.

3. Shqyrtimi i çështjes së pezullimit të nxënësve nga procesi mësimor të Shkollës së mesme “Xhelal Hajda-Toni” në Rahoveci dhe “12 Maji” në Ratkoc.

Kryesuesi –këtë pikë e kemi shqyrtuar në KPF dhe kemi ardhur në përfundim që të dalim me dy qëndrime. Një propozim ka qenë që për këta nxënës të mundësohet mësimi alternativ pas përfundimit të vitit shkollor, t’i nënshtrohen edhe njëherë provimeve të asaj klase dhe propozimi tjetër ka qenë që këta nxënës të përjashtohen nga procesi mësimor, t’i humbet viti.

Floriqe Boshnjaku, –drejtoresha e DKA-së në bazë të Ligjit të arsimit në fuqi i ka marrë të gjitha masat. Drejtori i shkollës ka bërë pezullimin për 3 ditë, pas 3 dite DKA i ka pezulluar këta nxënës për një muaj, ndërsa pas një muaji, dhe në bazë të inspektorit regional të arsimit kemi ardhur në përfundim që kjo është kompetencë e Kuvendit komunal, në bazë të Udhëzimit administrativ nr. 6/2010 i cili ju është dërguar edhe juve. Neni 7.1.4 është: masat nga paragrafi 6.3.1.4 i shqipton Kuvendi komunal duke siguruar mësim alternativ për nxënësit e pezulluar. Këta nxënës kanë qenë të pezulluar 3 ditë nga drejtori i shkollës, një muaj nga DKA dhe tani është kompetencë e juaja se si do të vendosni për këta nxënës.

Lumturiqe Hoti,– këtë çështje e kemi diskutuar edhe në KPF dhe inspekcioni ka qenë në SHM “Xhelal Hajda-Toni” dhe nuk ka hasur në asnjë parregullsi lidhur me mungesa dhe vërejtjet dhe i ka ardhur në përfundim se drejtoresha ka vepruar konform Ligjit, rregullores së shkollës dhe udhëzimit administrativ. Sipas Ligjit jemi të obliguar këtyre nxënësve t’ju sigurojmë mësimin alternativ. Kolegët në shkollë thonë se nxënësit nuk kanë pasur pajisje për edukatë fizike dhe ka ardhur deri te përjashtimi nga ora. Në bisedë me kolegët në shkollë ata propozojnë që këta nxënës të ndëshkohen me të holla,të bëjnë një pagesë por, a e lejon këtë ligji nuk e di.

Rustem Thaçi - nga raporti i drejtoreshës edhe parafolësja e ceku se aspekti procedural i pezullimit të nxënësve nga procesi mësimor është respektuar. Unë propozoj që për këta nxënës të merren masat të parapara me ligj që ti nënshtrohen provimeve të klasave në fund të vitit shkollor, mirëpo statusin e nxënësve të rregullt ta humbin. Kam një kërkesë që të sigurohet një punëtor i sigurimit në të dyja ndërrime në SHM “12 Maji” në Ratkoc. Kemi probleme me nxënës që i kemi përjashtuar, nuk na shmangen prej shkollës. Është mirë që Polica, në turnin e dytë pas dite ta frekuentojnë shkollën, të sigurohet edhe rroja e natës.

Fehmi Hoxha,– këtu janë kompetencat e ngatërruara. Neni 5 thotë: të drejtën e pezullimit më shumë se një muaj e ka Komuna e cila ka për detyrë organizimin e arsimit alternativ të nxënësve, Komuna – Ekzekutivi. Qeveria, stafi komunal siguron arsimin alternativ e jo Kuvendi komunal, është punë e Qeverisë e cila duhet të merret me këtë e jo Kuvendi.

Labinot Berisha,– e kuptova interpretimin e dispozitave të Rregullores 06/2010 kur kanë të drejtë të largohen nxënësit, por në këtë dispozitë përpos të drejtave kanë edhe disa detyrime edhe arsimtarët, edhe Drejtoria e shkollës. Por, rregullorja thotë që arsimtari i klasës dhe Drejtoria e shkollës në rastin e suspendimit para 3 ditë duhet të informoj prindërit. A e kanë informuar prindin? Me Konventën ndërkombëtare nën moshën 18 vjeçare janë fëmijë, dhe më pëlqeu kolegu i cili tha “atëherë këta fëmijë duhet me i dërguar në burg të Dubravës”. Prej fëmijëve të padisiplinuar po i ktheni në fëmijë delikuent, po edhe mësimi alternativ dhe ai në riprovim në fund të vitit, prapë janë të dëmshme për fëmijë për faktin që s’ mund të jenë të suksesshëm të kalojnë vitin në fund pa i ndjekë orët dhe, mos harroni se vetëm në Ratkoc janë 28 fëmijë dhe fakti që ka ndërhy dhe avokati i popullit për këtë çështje tregon se është çështje e ndjeshme e që është pasojë e një sistemi shumë të dobët dhe të dërmuar të arsimit këtu. Mos harroni që në Shkollën “12 Maji” ka arsimtar, profesor që kanë mbi 32 mungesa dhe kjo është shumë e vërtetë dhe pse nuk ngritët edhe kjo çështje. Në këtë shkollë në një klasë ka mbi 45 nxënës dhe nuk ka karriga të ulet nxënësi e që kjo është e kundërligjshme sepse ka të bëjë drejtpërdrejt me dëmtimin e shëndetit fizik të fëmijës, dhe si mund të kërkohej që këta fëmijë të përjashtohen. Këtyre fëmijëve nuk u është thënë se janë suspenduar për 3 ditë, por unë jam dëshmitar që ju kanë thënë jeni përjashtuar. Në Shkollën “12 Maji” në Ratkoc ekziston një lokal afër shkollës ku konsumohet

alkooli, duhani, ku ulen profesor dhe nxënës., vendimi është i padrejtë por le të mbetet në përgjegjësinë morale dhe institucionale.

Xhemali Haxhimustafa – nuk është e drejta e jonë që të merremi me këtë çështje sepse janë gjëra të prera me ligj, rregullore dhe udhëzime administrative. Janë organet tjera të cilat duhet me dhënë mendimin se a janë në kolizion me ligjin. Neni 5 dhe neni 7.1.4 ku njëri prej tjetrit kanë dallime. Në nenin 7 thotë Kuvendi ndërsa në nenin 5 Komuna. Ky Udhëzim administrativ është dashtë urgjentisht të përmirësohet për arsye se ka mos qartësi në të, mirëpo në nenin 6.1.4 thotë: pezullimi më shumë se një muaj i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet edhe pasi i janë shqiptuar masat si vërejtje. Kjo masë shqiptohet në rastin e sjelljes së dhunshme apo agresive e cila nuk lejon vazhdimin e procesit edukativo-arsimor të nxënësve , do të thotë pengon mësimin, kur mungon mbi 32 orë, pa arsye nga mësimi, mos zbatimi i vendimeve të organeve të shkollës dhe rastet tjera që parashihen me rregullore të shkollës. Është ligji, rregullorja e shkollës, kujdestari i klasës, drejtori, Drejtoria dhe instanca më e lartë Kryetari i Komunës dhe në fund Paneli për ankesa dhe parashtresa pranë MASHT-it i cili merr në shqyrtim ankesën e tij dhe e pezullon vendimin e mëhershëm. Është e palogjikshme që Kuvendi të merret me këso vendime sepse ne nuk guxojmë të shqyrtojmë vendime të cilat hyjnë në kompetencën e kryetarit të Komunës, drejtorit të Drejtorisë apo drejtorit të Shkollës. U tha këtu se janë larguar nga ora për shkak se nuk kanë pasur pajisje. Në qoftë se e ka larguar nga procesi mësimor për shkak se nuk ka pasur pajisje nuk ka të drejtë me e lënë pa notuar, prandaj është e palogjikshme që të merrem me këtë vendim i cili në mënyrë taksative i parasheh gjëra se kush ndërmerr masa në lidhje me këtë.

Feim Fetoshi – në KPF kam bërë ca pyetje por për fat të keq nuk kam parë asnjë përgjigje. Konsideroj që është një propozim shumë i dobët , përpos citimit të disa neneve ka vetëm tre-katër rreshta, për tu marr me fatin e 30 të rinjve. Zonja drejtoreshë, unë kërkoj nga ju që në faqen e 2 të këtij propozimi edhe në KPF kemi pasur vendim kurse tani kemi propozim ndërsa është i njëjti numër që është diçka e pazakonshme. Menjëherë në fund të këtij propozimi shkruan që sipas nenit 31.4 dhe 31.5 të Ligjit mbi arsimin fillor dhe të mesëm kurse në faqen tjetër neni 5 pika 1,2 dhe 3 si dhe të Udhëzimit administrativ nr. 5004. a janë cituar nga Udhëzimi administrativ 5004 apo nga Ligji për arsimin fillor dhe të mesëm dhe dëshiroj përgjigje për këtë.

Floriqe Boshnjaku –në lidhje me këtë keni nenin 31.4 të Ligjit, pastaj nenin 5 pika 1, 2 dhe 3 të Udhëzimit administrativ dhe për çdo paqartësi mund të kërkon përgjigje nga drejtoresha në DKA.

Feim Fetoshi – neni 5 pika 1,2 dhe 3 i referohet Udhëzimit administrativ 5004 ku neni 5 thotë: Instrumentet për matjen e suksesit, pika 5.1 është shumë me rëndësi që mësimdhënësi gjatë procesit të matjes dhe në përputhje me qëllimin e vlerësimit të përdor mjetin më efikas për mbledhjen e informatave të mjaftueshme para se të sjell vendim për shkallën e arritshmërisë së nxënësit, pika 5.2 gjatë procesit të vlerësimit në klasë, mësimdhënësi është i obliguar të përdor të gjitha llojet e instrumenteve përkatëse për matje në përputhje me qëllimet dhe objektivat e vlerësimit dhe pika 5.3 që po ashtu i referoni është i palejueshëm i vetëm i një mjeti të matjes sikur që nuk lejohet zëvendësimi i një mjeti me mjetin tjetër. Pyes se çka ka lidhje kjo me përjashtimin e nxënësve, kur këtu thotë është Udhëzim për arsimtarë se si të vlerësohen nxënësit.

Floriqe Boshnjaku – me këto drejtoresha ka dashtë të tregojë procedurën se si ka ardhur deri te kjo çështje që është shumë me rëndësi. E lexova Ligjin për arsim fillor dhe të mesëm, Udhëzimin administrativ dhe pajtohem me Xhemaliun se ne nuk e bëjmë interpretimin e ligjit, mirëpo për momentin kështu e thotë Udhëzimi administrativ.

Feim Fetoshi – çka ka lidhje ky nen i U.A. nr. 5004 që është cituar neni 5 pika 1, 2 dhe 3 çka ka lidhje me këtë temë, sepse këtu thotë se si të notohen nxënësit. Nga kjo mund të konkludohet se ka të bëjë me një jo profesionalizëm i personit që e ka nxjerr këtë.

Smajl Latifi, kryetari i Komunës – nuk jemi në komisionin për hartimin e ligjeve dhe udhëzimeve administrative, por çështja është konkrete. Janë pezulluar 30 nxënës, ka një propozim dhe ne duhet ti japim përgjigje çështjes. Duam që ti nënshtrohen provimeve të klasës në fund të vitit apo

duam t'iu humbim vitin këtyre nxënësve. Ligji thotë nuk kemi të drejtë t'i përjashtojmë nxënësit. Është marr masa nga drejtorët e shkollave, nga DKA dhe tani duhet të shqiptohet masa nga Kuvendi komunal. Për këtë çështje ekziston komplet dokumentacioni në DKA i cili është shumë voluminoz në lidhje me këtë çështje të cilin nuk kemi mundur t'ju dërgojmë për shkaqet teknike. Ka dy propozime: të përjashtohen t'ju humbet viti apo t'i nënshtrohen provimeve të klasës.

Feim Fetoshi – ajo çka na është ofruar neve neni 5 pika 1,2 dhe 3 të U.A. nr. 5004 dhe pyeta pse drejtoresha e DKA-së e ka cituar këtë kur këtu flitet për formën e notimit. Nuk kam marr përgjigje, sa herë kanë biseduar kujdestarët me nxënësit, a janë ftuar prindërit si dhe a ka biseduar drejtori i shkollës me këta nxënës dhe prindërit e tyre, a është organizuar ndonjë takim me nxënësit dhe psikologë dhe pedagogë të Ministrisë së arsimit dhe çka ka bërë DKA që këta nxënës të mos vijnë në këtë pikë. a janë organizuar takime pune lidhur me dobësitë e mësimdhënësve, a janë organizuar panele me nxënës problematikë, këtu nuk është vetëm vërejtja për drejtoreshën por edhe për disa koleg këtu që punojnë në arsim, sepse keni ardhur në atë pikë nxënësit e këqij dhe gjuaji në rrugë. Neni 6 pika 3 shkruan: pezullimi nxënësit i shqiptohet kur nuk përmirësohet edhe pasi i janë shqiptuar masat si vërejtja me gojë, me shkrim, pezullimi i përkohshëm nga garat, ekskursionet, vizitat, shëtitjet, pezullimi për 3 ditë apo si masë e vetme. Është bërë një masë e pezullimit në bazë të këtij neni pa u aplikuar neni 6 – masat edukativo disiplinore, e që konsideroj se këtu është bërë një shkelje ligjore dhe janë cenuar të drejtat e fëmijëve. Është absurde që këta nxënës të pezullohen dhe në fund t'ju ofrohet kyçja e tyre në riprovim. Përderisa këta nxënës nuk kanë mundur të integrohen në shkollë pyes, si mundën këta nxënës tani në rrugë të mësojnë dhe të vijnë në qershor për të dhënë provime. Konsideroj që kjo është e palogjikshme, jo ligjore dhe në kundërshtim me të drejtat e fëmijëve. Drejtoresha e DKA-së në vend që t'i zgjidhë problemet merr aplikimin e masave ndëshkuese. Kam informata që për herë të parë në këtë vit nuk është mbajtur takim më 7 mars në të cilin do të vlerësoheshin të arriturat të arsimit dhe këtë e konsideroj si shkelje të madhe. Ligji 03/L-068 i datës 21.05.2008 – arsimi në komuna të Republikës së Kosovës thotë që zgjedhja e drejtorëve dhe zëvendësve duhet të bëhet në pajtim me procedurat ligjore me rekrutimin dhe kriteret ligjore të përcaktuara nga MASHT-i nga një komision i caktuar nga Kuvendi komunal, në të cilin dy anëtarë do të jenë nga Komuna dhe një nga MASHT-i. Është një konkurs i cili në këtë javë mbyllet për 10 drejtorë dhe zëvendës drejtorë. Pyes se si do të realizohet zgjedhja e këtyre drejtorëve kur ju nuk keni caktuar Komisionin për intervistim në bazë të Ligjit të arsimit në komunat e Republikës së Kosovës. Andaj unë këtu shoh një jo profesionalizëm të plotë nga drejtoresha e DKA-së kërkoj me dhënë dorëheqje sa më shpejtë dhe nëse këtë nuk e bënë kërkoj nga kryetari i Komunës që ta shkarkoj këtë zonjë, se për ndryshe po cenohet programi i AAK-së në lidhje me arsimin.

Nahit Elshani – në mbledhjen e KPF kemi marr një material të emërtuar si vendim ndërsa tani e ka përmirësuar dhe është propozim për nxënës të pezulluar, këtu kemi të bëjmë me një jo profesionalizëm, është një pasqyrë e keqe e kësaj Qeverie komunale që në fillim, dhe mendoj që kryetari duhet t'i shqyrtoj këto dokumentacione para se t'ia sjell KPF dhe Kuvendit komunal në mënyrë që këto dokumente të mos mbesin në arkivin e Komunës. Është drejtori që duhet të jetë shembull për hartimin e dokumenteve. Në vendimin e parë kemi detajisht të paraqitur edhe numrin e nxënësve, me mungesat dhe notimin e tyre. Është mirë që po shqyrtohet edhe në Kuvend kjo problematikë, por këtu duhet të fillohet nga drejtori, profesori i cili nuk ka notuar nxënësit dhe pse nuk i ka notuar. Në KPF kam qenë për t'ju përsëritë vitin këtyre nxënësve sepse një nxënës i cili ka kaluar mbi 200 mungesa, ka mbi 9 nota të dobëta, i pa notuar, si mund të barazohet me nxënësin i cili ka vijuar vazhdimisht mësimin dhe ai në fund të vitit i jep provimet qysh i jep dhe bëhet prapë vitin tjetër problem i njëjtë. Propozoj që kryetari i Komunës në bashkëpunim me drejtorinë në fjalë ti propozoj Kuvendit komunal një Rregullore për çështjen disiplinore në shkollat tona, jo vetëm për nxënësit, por edhe për arsimtarët dhe profesorët ndërsa çështjen pedagogjike, mësimore e rregullon Ligji.

Smajl Latifi – pajtohem që duhet një propozim Rregullore për masa disiplinore bile një propozim rregullore e cila duhet të bëhet që Kuvendi komunal të jetë më serioz dhe të respektojë kodin e

sjelljes, të debatit, kohëzgjatjen sa herë ka të drejtë këshilltari të merr fjalën. Tërë Qeverinë e kam këtu për respekt ndaj Kuvendit dhe për ta afirmuar gatishmërinë tonë që të bashkëpunojmë dhe të jemi të hapur me Kuvendin. Propozim Rregulloren për çështjet e disiplinës, rendit dhe rregullit në shkolla në takimin e ardhshëm do t'ia prezantojmë Kuvendit. Për sa i përket asaj se a është Qeveri provuese ajo është kompetencë e kryetarit të Komunës dhe sipas Ligjit mbi vetëqeverisjen lokale është punë provuese për drejtorët dhe për të gjithë ata shërbyes civil të cilëve ju ka skaduar, kanë vetëm tre muaj, për faktin që është një lëmsh i ngatërruar në institucionet komunale dhe unë e kam votën dhe besimin e qytetarëve për të vendosur rregull, rend, disiplinë në punë, respektimin e orarit të punës dhe përgjegjësi. Performancën do ta pasqyrojmë në muajin maj sepse vendimet i kanë deri më 30 prill, ku do të flasim hapur çka kemi bërë gjatë këtij tremujori dhe ç'kemi në plan të bëjmë, do të jemi shumë transparent dhe do ta njoftojmë publikun. Po të silleshin drejtorët e drejtorive të mia në këtë mënyrë me marr fjalën nga 3-4 herë unë i kisha shkarkuar menjëherë. Në DKA mund ti shihni emrat dhe mund të siguron dokumentacion të nevojshëm se cilat janë arsyet e pezullimit të këtyre nxënësve nga drejtorët e shkollave, nga DKA dhe tani kjo çështje ka kaluar në Kuvend. Keni Udhëzimin administrativ nga i cili mund të shihni se kush e shqipton masën ndëshkuese për këta nxënës të pezulluar.

Avdullah Kryeziu – kërkoj interpretim ligjor të Ligjit mbi arsimin Nr. 03/L-068 të cilin jemi të obliguar ta respektojmë, Ministria ka edhe udhëzimet administrative, por ato nuk mund të jetë mbi ligjin. Nëse i referohemi nenit 5 pika i) të këtij Ligji ku thuhet: përgatitjen, miratimin dhe implementimin e Rregullores së punës për shkollat duke përfshirë kodin e mirësjelljes për stafin menaxherial, mësimdhënësit, personelin tjetër dhe nxënësit si dhe masat disiplinore. Prandaj duhet të miratohet një Rregullore komunale. DKA problemin e vet e ka bartë te kryetari i Komunës sepse edhe në Ligjin e arsimit thuhet diçka tjetër. Neni 6 pika c) monitorimi dhe raportimi i menaxhimit dhe veprimtarive arsimore në komuna kryhen nëpërmjet organit komunal administrativ gjegjësisht drejtori i cili i raporton kryetarit të Komunës, që thotë se ajo i raporton kryetarit dhe ai merr masa. Kuvendi komunal nuk ka të drejtë të merr vendimin për këtë çështje sepse kjo është çështje ekskluzive e Drejtorisë gjegjësisht e juve si kryetar i Komunës.

Salih Hoti,- Vendimin për pezullim e ka marr Drejtoria e shkollës për 3 ditë e pastaj DKA për një muaj, atëherë vetvetiu kjo çështje më nuk është në kompetencë të arsimit por në atë të Kuvendit komunal. Meqenëse në Udhëzim thuhet decidivisht që pezullimi më shumë se një muaj i shqiptohet nxënësit i cili nuk përmirësohet dhe pasi t'i janë shqiptuar masat dhe vërejtjet, me gojë, me shkrim. Nuk ka askush dëshirë me marr një vendim që i dëmton interesat e nxënësve por as interesat të nxënësve tjerë. Unë dëshiroj që këtë përgjegjësi me e pa jo vetëm te nxënësit por edhe te trupi pedagogjik, Nëse delegatët e KK-së nuk janë të bindur për vendimin që do të marrin kisha propozuar që të formohet një komision i KK-së prej 3-5 anëtarëve që të shqyrtoj komplet lëndën dhe të merret vendimi në mbledhjen e ardhshme.

Sinan Ejupi,- nëse një nxënës i bënë mbi 170 mungesa pa arsye ai nuk është më nxënës, sa është konsultuar prindi ato janë çështjet të cilat ne nuk mund t'i vërtetojmë, por propozoj që të votojmë dy alternativa: të nënshtrimit të provimeve apo jo të nxënësve në fjalë.

Rasim Fazliu – në Komitetin për politikë dhe financa kemi dhënë propozim që të dalim me dy variante: ose nxënësve t'i sigurojmë mësim alternativ ose të riprovohen.

Esad Haxhijaha,- në rastet kur duhet të largohen nxënësit instanca e fundit është DKA-ja dhe nuk largohet nxënësi por me kusht bartet në një shkollë tjetër të mesme në kuadër të komunës ose komunës fqinje, kurse shqyrtimin ankesës së nxënësit e bënë MASHT-i e jo Asambleja komunale.

Beatrisa Demiri –se kujt kush ia ka gjuajt problemin është më me pak rëndësi se sa fati i 30 nxënësve që janë në udhëkryq duke pritur në përgjigje. Unë ju ftoj që të vendoset drejtë në favor të këtyre nxënësve. Unë jam që nxënësit të kthehen në mënyrë aktive në procesin mësimor dhe t'i nënshtrohen provimeve në fund të vitit.

Elhami Zhuniqi – pajtohem me z. Salihu që të formojmë një Komision për një vendim meritor, të shqyrtohen të gjitha faktet dhe rrethanat se si ka ardhur deri te suspendimi i nxënësve nga procesi mësimor.

Labinot Berisha,– 30 nxënës nuk janë në shkollë, ata po humbin jo orë por ditë dhe muaj, ndaj duhet shikuar masat lehtësuese. Që nga drejtoresha, shkolla ka shkuar në masën e ndëshkimit e jo të përmirësimit. Kërkoj përgjigje nga Florija e cila ka marr rolin e drejtoreshës të DKA a është dërguar me shkrim vërejtja. Pajtohem me Salihun që të formohet komisioni sepse po humben orët dhe po bëhet shkelja e të drejtave të fëmijëve.

Rukije Krasniqi – vetë shefat e grupeve parlamentare po na torturojnë, vetë i kanë përpiluar këto pika dhe tani janë në kundërshtim me ato. Jam dakord për kthimin e nxënësve në shkollë. Ky problem është prej vitit të kaluar nga se nuk funksion trekëndëshi pedagogjik sepse s'ka bashkëpunim me prindër apo me nxënës. Duhet të marrim një vendim të drejtë pa shikuar interesat personale dhe partiake.

Ilirjana Gashi,– në nenin 7 thuhet se për të gjitha masat e ndërmarra duhet të njoftohen prindërit. Ne sot po vendosim për fatin e fëmijëve të tyre a do të jenë në shkollë apo në rrugë . Nëse prindi nuk është i informuar ndërsa nesër i shkon një vendim prej KK-së që fëmiju i tij nuk mund të shkojë në shkollë, kush do t'i përgjigjet prindit dhe si do të reagojnë ata. Do të ishte mirë që sot të ishin prezent 2-3 prindër prej këtyre nxënësve dhe të shohin çfarë vendimi do të marrim si Kuvend.

Rrustem Thaçi,– u tha këtu se na nuk kemi ndjenja as si profesor e as si arsimtar dhe më vjen shumë keq që i dëgjova këto fjalë. Këta fëmijë që tani janë jashtë shkollës, nëse dëshirojmë t'i ndihmojmë se veç 3 muaj janë jashtë procesit mësimor, dhe zgjidhja më e arsyeshme për ata është provimet e klasës në fund të vitit.

Smajl Latifi,– nuk pajtohem me propozimin e Salihut për formimin e Komisionit dhe duhet të vendosim për masën e shqiptimit të dënimit të këtyre nxënësve, me transferim në shkolla tjera apo duke ju nënshtruar provimeve në fund të vitit. KK-ja nuk siguron mësim alternativ, por Ekzekutivi i komunës krijon kushte për këto, por masën e shqiptimit të dënimit jep Kuvendi komunal dhe në këtë rast Ligji e saktëson që nuk kemi të drejtë t'i përjashtojmë nxënësit. Por nëse i transferojmë atëherë i marrim edhe obligimet buxhetore. Unë ju ftoj që të merret në konsideratë propozimi për dhënien e provimeve të klasës se sa propozimi për transferim.

Xhemali Haxhimustafa,– e vetmja gjë që mund të votojmë është se a e përkrahim ne kryetarin e komunës sipas Ligjit, sepse ka kaluar mësimi alternativ pasi që gjysmë vjetori është kryer dhe tani ata duhet ti nënshtrohen riprovimeve. Çështje tjetër është që kush është tash kompetent që t'i lejoj atyre të hynë në riprovime. Gjëra janë të qarta dhe Ligji ju lejon, jeni kryetar i Komunës i cili ka verdiktin e popullit dhe ne ju përkrahim, prandaj duhet marr vendim të tillë.

Në lidhje me këtë pikë kryesuesi ka hedhë në votim dhe me 2 abstenime është marr KONKLUSIONI që mbështet kryetari i Komunës që të veprojnë sipas Ligjit lidhur me çështjen e pezullimit të nxënësve nga procesi mësimor, që nxënësit të dalin në riprovim në fund të vitit.

Smajl Latifi – unë vendosi në favor të Drejtorisë komunale për arsim që nxënësit t'i nënshtrohen provimit në fund të vitit.

4. Shqyrtimi i projekt vendimeve për caktimin e zonave të interesit të veçantë.

Ramadan Gashi, drejtor i Drejtorisë për urbanizëm – sipas ftesës nga Ministria e tregtisë dhe industrisë, komuna është kompetente për hapësirën e vet në gjithë territorin e Komunës së Rahovecit. Këtu janë disa sipërfaqe të propozuara nga Drejtoria për kadastrë dhe pronë, dhe Komuna ka të drejtë të iniciojë procedura për këto prona të cilat janë hapësira publike. Ne i mirëpresim plotësimet dhe propozimet eventuale në mënyrë që të nxjerrim një dokument që do të ndikojë në Planin strategjik zhvillimor të Komunës së Rahovecit.

Kryesuesi – zona e parë që përfshin sipërfaqet përgjatë rrugës në Opterushë që do të jetë zonë ekonomike industriale ndërsa zona tjetër që është rruga për Malishevë është e destinuar për vendosjen e objekteve turistike, ushqimore, zanatlinj, artizanat, ekonomitë familjare, objektet tregtare e tjera, ndërsa për zonën e tretë që është në Xërxe, pjesa e Gradshit, faktikisht kjo është

propozuar, mirëpo kjo zonë është shpallur në vitin 1986 si zonë nën mbrojtje dhe për këtë pjesë ndoshta nuk ka nevojë të merret vendim.

Salih Hoti – vendimi për caktimin e zonave të veçanta profesionalisht është në nivel dhe është i mbuluar me hartat gjeodezike dhe është me leverdi dhe interes të përgjithshëm që këto zona të mbrohen, vendimi të paktën të shërbejë për mbrojtje dhe mos tjetërsimin e tyre. Dy zonat e para të përcaktuara pjesa nga Malisheva dhe ajo për Apterushë nuk dyshoj se ka konflikt i interesit me parcela përreth, ndërsa në zonën e tretë në Gradish mund të ketë ndonjë konflikt interesi, për shkak se jemi dëshmitar të tjetërsimeve në forma të ndryshme, të ligjshme e të paligjshme që janë bërë në këtë pjesë, dhe ka njerëz që i kanë tjetërsuar ato sipërfaqe atje gjë që është një dëm për Komunë tonë. Është mirë që Komuna të ketë të dhëna shumë të sakta për shkak se mund të ketë ndodhë që këto tapi që i kemi këtu, ndoshta janë ndryshuar kohëve të fundit. Dëshiroj të di se a ka implikime buxhetore rreth kësaj dhe në mbështetje të këtij vendimi me çfarë infrastrukturë do të përcillet ky vendim. Te analiza e legjislacionit thuhet që këto duhet të harmonizohen me Planin hapësinor të Kosovës, a disponon Komuna me një kopje të Planit hapësinor të Kosovës me qëllim që të bëjë harmonizimin dhe të mos jenë në kundërshtim njëri me tjetrin. Kisha kërkuar që këto vendime të mos mbesin vetëm në letër por të zbatohen dhe kisha kërkuar trajnim të veçantë rreth zonës së Gradishit.

Rrustem Thaçi – ekziston vendimi që është shpallur zonë e mbrojtur e kanjonit të Drinit të Bardhë, mirëpo po ju japë edhe një informatë se në majë të Gradishit është një kala në sipërfaqe prej 2 hektarësh që është prej kohës së romakëve e cila kala ka qenë e lidhur me një shpellë, e cila lidhet prej majës dhe shkon deri te lumi. Nëse i kemi parasysh këto rrethana unë kisha pasur dëshirë nëse procedohet më tutje Gradishi të specifikohet se çfarë destinacioni do ti japim, e nëse bëhet gurthyes apo separacion i zallit unë jam kundër kësaj ndërsa nëse i jepet destinacioni në aspektin kulturor dhe turistik e rekreativ atëherë do të jem pro. Ne kemi bërë një përpjekje “Epopeja e Gradishit” ku kemi caktuar një lokacion prej 2 hektarësh dhe është thënë që të bëhet amfiteatër veror dhe Komuna duhet t’i ketë parasysh këto gjëra. Propozoj që kësaj radhe “Gradishi” të hiqet nga rendi i ditës.

Xhemali Haxhimustafa – kërkoj sqarim shtesë rreth këtij propozim vendimi për pjesën ku shkruan: vendosen objektet turistike, ushqimore, zanatlinj, artizanat, ekonomi familjare, objektet tregtare etj. Nëse është zonë turistike dhe nuk parcelohet, atëherë ekonomi familjare nuk përkojnë bashkë.

Elhami Zhuniqi – e shprehi shqetësimin tim në lidhje me përcaktimin e zonave të interesit të veçantë nga përvoja e mëhershme në rastin e fshatit Fortesë ku është caktuar zona e interesit të veçantë pa pëlqimin e qytetarëve të fshatit dhe është caktuar një destinacion për ndërtimin e Fabrikës së tjegullave, prandaj duhet të jemi shumë të kujdesshëm që zonat e interesit të veçantë të mos shndërrohen në zonat e interesit personal të njerëzve dhe pastaj t’i ndërrohet destinacioni. Duhet së paku të merret mendimi i qytetarëve të cilët janë afër këtyre zonave ngase ata atakohen drejtpërdrejt, sepse qytetarët e fshatit Fortesë janë të revoltuar me vendimin e marr dhe në të ardhmen do të prodhon efekt negativ, prandaj duhet të jemi shumë të vëmendshëm rreth shpalljes së këtyre zonave me interes të veçantë, sepse mund të ketë edhe probleme pronësore dhe çështje të ndryshme të cilat mund të implikohen në këtë rast.

Jeton Kryeziu – propozuesi i Drejtorisë për ekonomi dhe zhvillim për propozimin e vendimit për zonat e interesit të veçantë, në këtë rast pika III– zona kadastrale Gradish në Xërxe konsideroj se duhet të diskutohet në një debat tjetër.

Labinot Berisha – i mbështes parafolësit, por kam një pyetje për drejtorin përkatës se a ka pasur diskutim publik me qytetarë për shpalljen e interesit për këto zona ku gravitojnë ato sepse nga informacionet që kam në disa nga këto zona ka edhe parcela private.

Esad Haxhijaha – në vitin 2005-2006 Asambleja komunale ka marr një vendim për shpalljen e zonave industriale në drejtim të Apterushës dhe Malishevës me destinacion të caktuar, nga kjo edhe nuk e shoh arsyen pse nëse kemi të shpallur njëherë pse të merremi për së dyti me këto punë e nëse veç duhet të bëjmë këtë atëherë vendimin paraprak duhet të shpallim të pavalershëm dhe të

merremi me propozimin e ri. Nuk shoh ndonjë risi në vendimin e tanishëm në krahasim me vendimin e mëparshëm i cili është në fuqi. Sa i përket Gradishit është një regjion e gjerë dhe përfshin një hapësirë bukur të madhe ndërsa zona turistike e mbrojtur është prej lumit Drini në drejtim të Rahovecit rreth 500 m që do të thotë se nuk e përfshin tërë Gradishin. Pjesa kah Gexha është zonë e cila mund të parashihet për ndërtimin e ndonjë objekti, por jo të ndërtohen gurthyes por të jetë një zonë rekreative turistike si dhe pjesa rreth lumit Drini mund të shërbejë si pjesë rekreative. Nëse kjo tani është nevojë të cilën e kërkon edhe Ministria atëherë duhet së pari të rregullohet infrastruktura dhe pastaj të shpallen këto si zona të interesit të veçantë. Nahit Elshani – mendoj që për një Komunë siç është Komuna e Rahovecit është e rëndësishme të ketë zona të caktuara për afarim të bizneseve, mirëpo sa i përket rastit në fjalë mendoj që edhe pse këtu thuhet që shihe dokumentin që e ka dërguar Ministria për tregti dhe industri të cilën nuk e kemi në material dhe nuk e di se çfarë ftese është. Po ashtu këtu thuhet që lejet e ndërtimit i japin tri drejtori, ndërsa e di që leje ndërtimi e jep një drejtori kurse pëlqimet i japin edhe drejtoritë tjera. Vendimi thotë që është i përhershëm, nuk e di që komuna ka të drejtë të tjetërsojë prona të veta apo të jep leje të përhershme. Ne në vitin e kaluar kemi shpallur dy prona me interes të përgjithshëm dhe atë një në Fortesë e një në Krushë të Madhe, për ndërtimin e dy fabrikave dhe i kemi dhënë në një afat kohor të caktuar për 40 vite, kështu që nuk duhet të lëshohet vendimi me afat të përhershëm. Ajo që është shqetësuese për mua se Qeveria komunale në këtë rast nuk ka bërë asnjë tentim apo asnjë debat, as me qytetarët e Komunës ku janë këto zona, në rastin konkret te fshati Apterushë e po ashtu nuk ka bërë debat as me bizneset. Nëse këto zona janë për bizneset e Komunës së Rahovecit, atëherë të paktën duhet të pyeten edhe ata se ku e shohin interesin e tyre për të zhvilluar aktivitetin e biznesit dhe afarist dhe komuna duhet t’iu ofrojë më shumë alternativa dhe me debat ata të vendosin se ku është më me interes për ata për të caktuar një zonë për zonë industriale apo për park të biznesit. Këtu kemi të bëjmë me tri prona që janë caktuar, dy të para kanë të bëjnë me prona të cilat i ka në shfrytëzim Ekonomia e pyjeve dhe as këtu nuk është punuar se a lejon Ekonomia e pyjeve që do të thotë se Qeveria komunale duhet të zhvilloj biseda me Ekonominë e pyjeve në mënyrë që ata të japin leje apo pëlqim për të shpallur këto zona me interes të përgjithshëm për zhvillimin e aktiviteteve biznesore. Tjetër që është me rëndësi se ish Qeveria komunale ka filluar me hartimin e planit strategjik zhvillimor të Komunës e që ne nuk kemi pasur rast të njihemi me atë plan, që është shumë me rëndësi gjatë fazave të aprovimit të këtij plani strategjik zhvillimor komunal. Komuna respektivisht Qeveria komunale të debatoj me qytetarë, me grupet e interesit në këtë rast me shoqatat të biznesit, të afaristëve dhe të zejtarëve, në mënyrë që në këtë plan strategjik zhvillimor të caktohen saktë këto zona dhe të cilat të jenë vërtetim në shërbim të atyre që do të afarojnë aty. Në këtë propozim vendim po ashtu nuk ka kosto financiare, nuk dimë sa do të kushtojnë këto zona për rregullimin e tyre, për ofrimin e infrastrukturës, sepse nëse i shpallim ashtu si që ka qenë në të kaluarën do të jenë jo funksionale, andaj mendoj që këto vendime janë të papërgatitura dhe për sot ne si grup i këshilltarëve nuk do të votojmë përderisa nuk përgatiten mirë dhe nuk ofrohen informata shtesë për këto çka kam kërkuar unë.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – konsideroj që ky material i përgatitur dhe që është para jush është profesionalisht në nivel, bazohet në vendimet që janë marr më herët e të cilat vendime kanë qenë me karakter të përkohshëm dhe synimi ynë është që këto vendime të jenë me karakter të përhershëm si zona të interesit të veçantë të Komunës. Se kujt do ti jepen ato zona për zhvillimin ekonomik do të jepen me kohë të caktuar, por ne si Komunë duhet t’i shpallim zona me interes të veçantë dhe të kemi një vendim edhe për preventivë por edhe për mundësi për zhvillim ekonomik dhe zhvillim në përgjithësi në të ardhmen. Ftesa nga MTI është e qartë që deri më datë 30 mars komuna jonë dhe komunat tjera në Kosovë duhet të shpallin zona me interes të veçantë, duhet të nxjerrim vendimin për shpalljen e këtyre zonave. Është e vërtetë që nuk kemi planifikuar buxhet, është e vërtetë që ka një kosto, është e vërtetë që duhet të harmonizohet me MPAH, por është e vërtetë që të gjitha gjërat, veprimet, masat i takojnë së ardhmes. Ne do të duhej të jemi të vëmendshëm dhe të përkushtuar që në të ardhmen t’i krijojmë ato kushte dhe për modalitetet ne

nuk kemi nevojë sot të flasim. Kërkesa nga MTI është e qartë, ndërkaq interesi jonë si Kuvend komunal dhe si qytetarë është që të mbrohen pronat me Ligj, të shpallen zonat e interesit të veçantë, zonat të cilat do t'i dedikohen zhvillimit të gjithmbarshëm të Komunës tonë. Është edhe një arsye shtesë, për 12 vite është bërë masakrimi i pronave, është bërë tjetërsim, ne kemi pasur një agjendë dhe do ta fuqizojmë, do ta intensifikojmë këtë agjendë edhe në Gjykatën komunale dhe me institucionin e Avokatit të Komunës dhe të gjithë mekanizmat tjerë që në të ardhmen nuk do të lejojmë më tjetërsim të pronave komunale. Për sa i takon asaj që lidhet me parcelën në drejtim të Malishevës, ne asgjë nuk kemi ndryshuar nga ajo që tha Esadi. Në pyetje të Xhemaliut, ajo zonë do të dedikohet më shumë për aktivitete turistike, biznese të vogla etj., do të ketë mundësinë më të madhe dhe së paku ky është orientim që është i bazuar edhe në vendimet e mëhershme, ndërsa për sa i përket Gradishit është shumë mirë nëse është zonë e mbrojtur, por do të jetë edhe më mirë nëse ne e fuqizojmë këtë mbrojtje. Pajtohem me Rustemin kur thotë që nuk do të duhej të lejojmë që të bimë ndesh me destinacionin e zonës. Ne kemi përgatitur një raport për sa i takon Ekonomisë pyjore. Sqarim për Nahitin: toka ndërtimore bujqësore dhe ajo pyjore e papjllëzuar në bazë të dispozitave të nenit 3 al. 2 të Ligjit mbi qarkullimin e pronës së paluajtshme të Kosovës nr. 45/81 me ndryshimet dhe plotësimet e tij i cili për shkak të mungesës të Ligjit të Republikës së Kosovës në bazë të Rregullores nr. 1999/24 dhe 2000/59 konsiderohet si Ligj i aplikueshëm, parashihet që personat shoqëroro juridik munden në mes vete t'i bartin pronën e paluajtshme pa kompensim nëse paraqitet ndonjë interes i përgjithshëm shoqëror. Duke u bazuar në dispozitat e këtij Ligji, Agjensioni Pyjor i Kosovës si person shoqëroro juridik ka të drejtë të kryej bartjen administrative të pronës së paluajtshme të papjllëzuar nëse paraqitet interesi i përgjithshëm shoqëror për nevojat e personit tjetër shoqëroro juridik pa kompensim, ngase palujtshmëria e cila kërkohet të bartet në emër të Komunës sipas ekspertëve pyjor të ish Ndërmarrjes pyjore "Koritnik" Prizren, nuk i plotëson kushtet natyrore as që i përshtatet rajonit. Për rajonet e papjllëzuara Komuna ka të drejtë mund të shpall interes të veçantë respektivisht nuk mund të jetë pengesë Agjensioni pyjor i Republikës së Kosovës në këto situata dhe në këtë drejtim besoj se nuk do të kemi paqartësi. Ftoj Kuvendin komunal që t'i shpallin këto zona me interes të veçantë sepse ne tashmë kemi përgatitur edhe një vendim tjetër i cili shumë shpejt do të procedohet në KPF i cili ka të bëjë me 12 prona tjera po ashtu me interes të veçantë. Mos të harrojmë që jemi në situatën kur ne duhet të veprojmë dhe ta mbrojmë pronën komunale me Ligj. Ne kemi tashmë një raport gjeneral për sa i përket evidentimit të pronave komunale kudo që gjenden në Komunën tonë.

Fehmi Hoxha – dy zona që i përmendi edhe z. Esadi kanë qenë të shpallura përkohësisht, atëherë a është caktuar për sa vite dhe faktikisht ne po i fuqizojmë tani me vendimin e ri këto dy zona që kanë qenë, ndërsa pjesën e Gradishit unë e kundërshtoj plotësisht sepse aty në të ardhmen duhet të përgatitet një projekt shumë i mirë dhe të bëhet një zonë kulturore.

Xhemali Haxhimustafa – pasi që mora sqarimin shtesë normal që lidhur me këto vendime do të diskutoj. Në disa nga diskutime nga parafolesit ka vend që njeriu të ketë shqetësim lidhur me këtë. Mjerisht nuk po them që është, ndoshta kanë qenë të detyruara edhe qeverisja kur ka qenë E. Haxhijaha kryetar i Komunës, por është detyruar edhe kjo, që të futemi në rrëzë të bjeshkëve të Millanoviqit dhe them se ne një anë thirrmi se në krijimin e kushteve biznese për biznesin e Komunës tonë apo më gjerë, në anën tjetër i ofrojmë diçka që është e klasës (zh) që nuk ka kurrfarë infrastrukturë. Ne si Komunë as që mundemi me i krijuar një komoditet të tillë pse nuk kemi hapësirë buxhetore apo financiare sepse biznesi kërkon infrastrukturë të përgjithshme, mirëpo në pamundësi që nuk kemi lokacione tjera, është caktuar aty. Për pjesën e Gradishit nuk dua të diskutoj sepse për këtë kemi biseduar në vitin 2007 ose 2008 kur është kërkuar dhe kemi thënë se është e paprëkshme sepse na është dokumentuar se është zonë e mbrojtur dhe nuk kemi çka të diskutojmë. Në vendim thuhet: këto zona të propozuara do të mund të rishikohen dhe riformulohen më vonë sa i takon i takon bizneseve dhe veprimtarive që do të keni brenda një zone të caktuar. Mund të merret si të duash dhe mund ti jap konotacion sa i duhet një biznesi, mund ta marr që edhe një Qeveri komunale cila do që të jetë se e ka marr verdiktin njëherë dhe

mund të bëjë çka të dojë sikur që tha dikush mund të shkojë edhe në interesa personale dikujt. E dyta kjo zonë për qytetin e Rahovecit e vetmja arterie ka mbetur kjo, unë i shoh njerëzit që dalin për ajër të pastër. Nuk është marr vendimi në mënyrë profesionale se për çka do të shërbejë kjo zonë, nuk dihet prej ku fillon dhe deri ku vazhdon. Në qoftë se i marrim të gjitha ato që në mënyrë taksative u specifikuan këtu, atëherë del goxha një biznes i madh dhe laramania e bizneseve, nuk del më as turistike, tregtare, zejtare por del çdo gjë dhe asgjë. Nëse do të kishte mundësi të specifikohet për çka është çështje tjetër dhe me hapësirë të caktuar. Prej vitit 2001 ka pasur përpjekje të kryhen disa veprime të cilat janë imediate më se të nevojshme në qytetin e Rahovecit me 25.000 dhe 73.000 banorë që ka Komuna jonë, dhe ende tregtia bëhet në rrugë, bulmeti shitet në rrugë për arsye se nuk ka hapësirë të mjaftuar për tregti e mos të flasim për drunj apo produkte tjera përcjellëse. Për të futur nën mbrojtje të mos keqpërdoren jam i pajtimit ndërsa për të bërë biznes në atë pjesë nuk jam i pajtimit dhe mendoj se është e hershme dhe jashtë çdo logjike.

Smajl Latifi – ideja është me iu përgjigj tendencës serioze që tash ne, po besoj që të gjithë jemi të gatshëm për me i mbrojtur me ligj pronat e Komunës tonë, njëkohësisht është tendencë pozitive për t’iu përgjigjur një kërkesë të MTI e cila ka projekte të caktuara që i dedikohen komunave të Kosovës dhe realizimi i të cilave duhet të ketë zona të zhvillimit ekonomik. Ne kemi deficit, mungesë hapësirash dhe jemi në kërkim të pronave ku ka Komuna jonë në çdo lokalitet të Komunës tonë, tashmë i kemi të gjitha informacionet edhe për pronat kontestuese edhe për pronat komunale që do të duhej të shpallehin me interes të veçantë, në të kundërtën ne rrezikojmë që të bëhen prona kontestuese. Në qoftë se do të vazhdohet me avazin e vjetër atëherë ne këto prona nuk do t’i kemi më. Për tu përballur suksesshëm me këtë rrezik ne duhet të reagojmë. Unë pajtohem që mund të ketë gjëra që lënë për tu dëshiruar, por gjithsesi mendoj që destinacioni i këtyre zonave është i qartë, zona të interesit të veçantë dhe njëkohësisht ne bëjmë dy veprime: si qytetarë, si deputet, si Qeveri i mbrojmë dhe fuqizojmë këto zona sepse po i vejmë nën mbrojtje të Ligjit dhe po i japim mundësi negociimit me MTI dhe me gjithë komunitetin e biznesit se çfarë do të bëjmë pastaj me këto zona. Natyrisht që ka një normë, rregull, standarde, kriteret të cilat vijnë në proceset e mëtejme. Ne sot jemi këtu për t’i dhënë për shkak se ka rrezik që të përballemi me situatat të cilat janë të pakëndshme për ne. Janë kërkesat e Qeverisë së Kosovës që ne duhet t’i përgjigjemi, por mbi të gjitha t’i përgjigjemi të qytetarëve dhe t’i mbrojmë me ligj këto prona dhe ti shpallim zonat e interesit të veçantë.

Feim Fetoshi – në fillim dëshiroj të përshëndes këtë nismë të kryetarit të Komunës për caktimin e zonës industriale, konsideroj se është një çështje shumë e nevojshme dhe e domosdoshme për Komunën. Po ashtu që është nevojë jo vetëm e Komunës por e gjithë qytetarëve në mbarë Komunën dhe po ashtu konsideroj që zhvillimi ekonomik të cilin ne pretendojmë është nevojë e gjithë qytetarëve, është domosdoshmëri por po ashtu mendoj që shprehi mendimin e dhe të juaj që jo vetëm ne këtu që jemi, por edhe të gjithë qytetarët e Komunës së Rahovecit e kanë dëshirën e plotë dhe ndjejnë nevojën e madhe edhe për zhvillim ekonomik dhe natyrisht që zhvillimi ekonomik vjen pas një infrastrukture, pas një zone industriale apo diçka të tillë. Mendoj se deri këtu është shumë mirë dhe lë vend për tu përshëndetur. Kam disa shqetësime që mendoj që është dashur dhe ka mundur me u përgatitë më mirë. Vetë fjala interes i përgjithshëm shoqëror apo interesi i veçantë shoqëror kuptoj që është interes jo vetëm i Komunës por i gjithë qytetarëve. Andaj unë mendoj që debati publik e sidomos debati me qytetarë të atyre zonave të cilat preken apo planifikohet të ndërtohen këto zona industriale është i domosdoshëm, në mënyrë që të mos vijmë deri te një pat pozicion siç jemi tani me fshatin Fortesë, ku pakënaqësia çdo ditë e më tepër po rritet për atë vendim që kemi marr pa një debat të mirëfilltë të qytetarëve. Ndoshta kishte me qenë mirë që drejtori para se të propozoj këtë është dashtë të bëjë një fizibilitet të zonës, sepse me fjalën fizibilitet unë kuptoj që ekspertët analizojnë, vërtetojnë, kontrollojnë dhe në fund japin një përfundim diçka është për tu bërë, ja vlen për të bërë, apo nuk vlen për të bërë. Tani shtroj pyetjen: çka nëse pasi të shpallim këtë zonë industriale, kur të bëhet fizibiliteti vijnë në përfundim ekspertët që disa prej sipërfaqeve nuk ia vlejnë të jenë zonë industriale dhe atëherë ne si Kuvend

komunal jemi në kundërshtim. Në anën tjetër një projekt apo fizibilitet apo një informacion më i madh kur të bëhet debati me qytetarë në një farë mënyre i bindim më lehtë qytetarët që këtë që po duam të bëjmë është diçka e mirë për vetë qytetarët. Në këtë situatë që jemi jo vetëm që nuk i kemi pyetur qytetarët, nuk kemi marr mendimin e tyre, por edhe sikur ti pyetshim mendoj që ka shumë pak informacione të cilat qytetarët ndoshta do të ndiheshin të frikësuar. Tek e fundit decentralizimi mendoj që ne nuk duhet ta kuptojmë vetëm në aspektin ligjor, por në aspektin demokratik dhe praktik. Pse e them këtë, në aspektin ligjor decentralizimi ka ardhur deri në komunë, por në aspektin demokratik dhe praktik, decentralizimi duhet të bartet më tutje deri te qytetari i thjeshtë.

Fehmi Hoxha – propozoj që kryetari pasi që është në fazën e mbledhjes së të gjitha shënimeve për prona shoqërore dhe kur të kompleton, të analizojnë edhe një herë dhe të dalin propozime ashtu si duhet, sepse mund të ndodh nesër që edhe ne të nuk dimë se ku janë pronat shoqërore dhe mund të ndodh të dalin vende më të përshtatshme se këto dy që janë propozuar.

Smajl Latifi – kërkesa nga MTI ka ardhur pasi që e kam marr unë mandatin. Ne deri më tani kemi dy vendime të cilat i ka marr Kuvendi komunal prej vitit 2001 dhe 2006 dhe nuk ka diçka tjetër të re. Ne tani do të jemi pjesë e projektit edhe për zonat tjera me interes të veçantë dhe duhet ti përgjigjemi me aplikacion kërkesës së MTI-së dhe për shpalljen e zonave me interes të veçantë nuk ka paqartësi. Fizibiliteti dhe gjitha çështjet tjera janë aktivitetet tona të përbashkëta të mëvonshme, kërkesa dhe ftesa janë është pikërisht që të votohet, sepse ajo janë votuar më herët ndërsa duhet të fuqizohen edhe një herë dhe asgjë më shumë.

Kryesuesi – këtu kërkon Ministria në mënyrë që ne të jemi konkurrent serioz për të përfutur lidhur me këtë projekt dhe për këtë duhet t'i shpallim zonat e interesit e nëse arrijmë që të kualifikohemi në këtë shpallje që ka bërë Ministria, atëherë faktikisht ato shpenzime i merr Ministria që e bënë vetë studimin e fizibilitetit.

Xhemali Haxhimustafa – është kërkesë e Ministrisë e cila kërkon që të hap rrethin që sa më shumë komuna të konkurrojnë për një projekt të cilin ajo do të financojë. Në qoftë se një statut komunal i cili është e drejtë e rezervuar i Kuvendit të komunës për aprovimin apo mos aprovimin e tij, duhet medoemos të del në debat publik ndërsa ne flasim për një zonë të caktuar që ka të bëjë me interesin e përgjithshëm dhe ne të marrim vendim që këtu të ndërtohet fabrika apo lokale etj., nuk kemi atë të drejtë edhe pse jemi të votuar të gjithë, sepse kemi të bëjmë me numër të caktuar të hektarëve që duhet njëherë e përgjithmonë të ngulfaten për një interes të caktuar. A jemi ne të thirrur dhe ekspertë që të bëjmë një studim të saktë dhe t'i japim vulë asaj pune për të caktuar një zonë për ekonomi edhe pse jam i vetëdijshëm që diku duhet të zhvillohet biznesi, mirëpo me të drejtë duhet nisur prej të kaluarës sepse kaluan 12 vite ndërsa ende nuk është gjetur zgjidhja adekuate për zhvillimin e biznesit, të ekonomisë, turizmit, tregtisë e gjërave tjera, kështu që po shkojmë prej një vendi në vendin tjetër për të gjetur alternativa aty për aty. Nuk është lehtë me marr një vendim për caktimin e një interesi të përgjithshëm për një zonë e cila është jetike për një vendbanim, mirëpo në përgjithësi e mbroj parimin se ajo i duhet Rahovecit për rekreacion.

Nahit Elshani – ne i dhamë arsyet tona dhe nuk mund të shpallet një zonë e interesit për zhvillimin e aktiviteteve biznesore pa e parë interesin e tyre vetë bizneset, e për të parë interesin e tyre, bizneset duhet të konsultohen dhe të debatohen me ata se ku e shohin ata të zhvillojnë aktivitetin e vet. Nuk mund të bëjmë gabimet e njëjta sepse kemi shpallur zonë në vitin 2001 dhe askush nuk ka shkuar atje të ndërtojë dhe ka mbetur ashtu. Tani a duam të shpallim njëjtë veç për të thënë se kemi në letër dhe të mos investoj askush apo duam të bëjmë diçka që është atraktive për bizneset por edhe për investitorë të huaj. Prandaj propozimin duhet vënë në votim dhe të konstatohet kush është për dhe kundër.

Smajl Latifi – arsyeja themelore është kontakti me bizneset, ju njoftoj që për herë të parë takim me biznese kemi mbajtur, ju njoftoj që për planin zhvillimor kanë me qenë të informuara bizneset dhe të gjithë ata që kanë nevojë të informohen. Nuk po kërkojmë të ndërtojmë shtëpi as për t'i dhënë leje dikujt për biznes, ne po kërkojmë që t'i shpallim zonat e interesit të veçantë, madje bëhet fjalë për vendimet që dikur janë shpallur dhe është më mirë të fuqizohen ato vendimet se sa

të lihen zvarr. Ne po kërcënohemi me prona dhe ju e dini mirë që ka njerëz të papërgjegjshëm që për interesat e caktuara kanë gjetur forma dhe i kanë tjetërsuar pronat e Komunës sonë.

Kryesuesi po e vejmë propozimin e vendimeve në votim. Kush është për? **5 “pro”, 7 kundër dhe të tjerët abstenuan. Konstatohet se propozimi i vendimit për shpalljen e zonave me interes të veçantë nuk aprovohet.**

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – mos aprovimi i kësaj pike është i çuditshëm dhe me karaktere frenuese dhe këtë çështje do të ngriti në Qeverinë e Kosovës.

5. Vendimi për orarin e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës së Rahovecit. Vendimi aprovohet njëzëri.

6. Plani i punës dhe informata e kryetarit të Komunës.

Smajl Latifi, kryetar i Komunës – për herë të parë në Komunën tonë dërgohet një Plan vjetor i punës në Kuvendin komunal dhe kjo është për t’u përshëndetur si një hap pozitiv. Ju të njëjtin mund të regjistroni në memoaret e juaja dhe kur do të vijë koha do të flasim për Planin e punës, sepse sot nuk është për diskutim, por mund të bëni pyetje për sqarim, por jo për të diskutuar. Tani do ta lexoj Informatën rreth angazhimeve të kryetarit të Komunës së Rahovecit për t’ju njoftuar juve si këshilltarë.

Informata do t’i bashkëngjitet këtij procesverballi.

Nahit Elshani – edhe Plani vjetor i punës është një informatë dhe një përmbledhje e dëshirave të juaja si kryetar i Komunës që mendoni t’i realizoni gjatë qeverisjes njëvjeçare, përndryshe Plani i punës ka shifra, ka një agjendë se kur do të realizohen ato projekte, duhet të bazohet në buxhetin e komunës që është aprovuar për vitin 2011 e po ashtu duhet të bazohet fuqishëm edhe në Kornizën afatmesme buxhetore 2011-2013. Këtu z.kryetar asgjë nuk kemi të bëjmë me Planin e punës. Nëse doni që KK-së t’i ofroni një Plan të punës për qeverisjen tuaj njëvjeçare është mirë që t’i ofroni një Plan të punës e jo një informatë të tillë, sepse këtu janë përzier objektivat, synimet dhe nuk mund të gjejë veten këtu.

Smajl Latifi–Ne kemi një Plan pune i cili përmban objektiva, synime dhe aktivitetet të cilat pas një viti ne mund të flasim se a po i përmbushim këto objektiva. Qeveria jonë ka plan ditor të punës, javor, mujor, tremujor, gjashtëmujor dhe vjetor. Ju e keni planin vjetor të punës ndërkaq planin tremujor dhe gjashtëmujor nuk ju prezantojmë sepse ka edhe shifra, Këtë Plan të punës dhe këto objektiva dhe synime, strategjinë operationale asnjë Qeveri nuk ja jep Kuvendit se si do t’i realizoj planet. Madje të gjitha këto janë aktivitete publike dhe mund t’i gjeni edhe në WEB faqen tonë, ne maksimalisht do të aplikojmë atë që quhet transparencë dhe llogaridhënie.

Labinot Berisha – e falënderoj kryetarin për dokumentin që na ka sjellë, në kuptimin e asaj që të jetë një shembull i mirë dhe për më tutje për të parë objektivat, por më lejoni në pikën ku mendoj se jam i pa kontestueshëm për shkak të përvojës dhe punës profesionale që bëjë që 10 vite në Sektorin e rinisë, në këtë pikë ndihem pak i zhgënjyer, sepse është përcjellë një praktikë që nuk i jepet hapësirë rinisë ngase vetëm në një pikë është përmendur rinia, ku thuhet që Komuna do të organizojë muajin e rinisë dhe kam përshtypje që drejtori nuk ka qenë i informuar se organizimin e bënë Ministria e kulturës, ndërsa vetëm shënimin më 13 shtator e bënë Komuna. Për mua është shumë e rëndësishme dhe dëshiroj të inkorporoni dhe këto çështje. Ju informoj se ekziston një Ligj për rini i miratuar, po ashtu më 12 gusht vitin e kaluar ministri ka nënshkruar edhe 4 udhëzime administrative, njëri prej tyre që obligon drejtpërdrejt Komunën dhe kisha pasur dëshiroj që nga Komuna ime të filloj ky implementim e që ka të bëjë me licencimin e Qendrës rinore. Dëshiroj të futet edhe 12 gushti, është Ditë ndërkombëtare e rinisë, por mos të jenë vetëm si ditë, por mos të harrojmë se në përqindje të numri të banorëve, popullsia më e madhe konsiderohet moshë rinore dhe Komuna e Rahovecit sa i përket përkrahjes së rinisë nga vetë institucionet e Komunës duhet të ketë një Plan të veprimit dhe strategji rinore të aprovuar me buxhetin e saj rinor, dhe ju informoj se janë disa miliona Euro që Komisioni evropian ish GTZ që i jep për rininë në Kosovë, dhe pa aprovimin e atij plani Komuna nuk mund të përfitoj donacione. Smajl Latifi – kemi edhe një dokument tjetër i cili është më i gjerë dhe pajtohem me këtë propozim dhe unë për çfarëdo lloj përkushtimi në interes të qytetarëve nga të gjitha fushë

veprimtaritë do të jemi të gatshëm të bashkëpunojmë dhe ky është mision i kryetarit të Komunës dhe Qeverisë komunale, për të bërë ndryshime pozitive dhe për ndryshime serioze në Komunën tonë.

7. Të ndryshme:

Xhemali Haxhimustafa – a është shpallur konkursi për të gjithë drejtorët e shkollave të Komunës të cilëve u ka skaduar mandati. Përgjigje kërkoj për mbledhje të ardhshme.

Mbledhja ka përfunduar në ora 16,30.

e s i,

Popaj

K r y e s u

Kujtim